



Polici kapet me 3.6 kg kokainë

Kryeinspektori Hamëz Demushi e kishte fshehur në tasin e pilafit

► FAQE 13

[SHQIPTARJA.com]

LEKË 30

VITI V - NR. 41 - E SHTUNË - 21-02-2015

SHQIP
ARKIVA

HIPOTEKAT ILIRJAN MUHO: JA SI ZGJIDHET NGERÇI PER 400 PALLATE



Kreu i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në një intervistë ekskluzive flet për rolin e institucionit në procesin e legalizimeve si dhe në pajisjen me tituj pronësie të 12 mijë apartamenteve në kryeqytet

► FAQE 11

MEDITIM



NGA ARBEN DUKA

Një administrator për Bashkinë e Tiranës

► Në faqen 20

KOMENT



NGA FATOS ÇOÇOLI

Integriteti dhe korrupsioni

Qeveria e sotme duket se e ka seriozisht me luftën ndaj korrupsionit gjatë të gjithë procesit të frenohet. Vepron ndaj denoncimit të parë në portalin online www.stopkorrupsionit.al, premtori se do të jetë pas çdo denoncimi të qytetarëve. Janë nisur të mira, përpara kamerave të televizioneve shkëlqejnë, por menjëherë pas, në realitetin e së përditshmes, u bie kallaji.


► vijon në faqen 16

PADIA

► FAQE 12

Filip Çakuli hedh në gjyq për shpifje Sali Berishën

Gazetari i kërkon ish-kryeministrit vetëm 1 lekë dëmshpërblim



BARAJ: MPJ TË REAGUJË

► FAQE 6-7

Devijimi i Vjosës, Greqia vendos në mars, si nisi idea

Avokati grek: "Ish-qeveria shqiptare u njoftua, nuk ktheu përgjigje"

"PERIFERI"



NGA ALBA MALLTEZI

Vajzat pa emër

Përsëritet si një ankh. Përsëriten rastet tragjike të personave publikë, politikanë, biznesmenë, gazetarë që në aksident – mësohet më vonë – ishin në shoqërinë e një vajze, të një gruaje, që nuk ishte bashkëshortja e që mbetet gjatë ose përjetësisht pa emër në kronikat mediatike, por jo në përshpërjetit mes qytetarëve. Njerëzit inatosen me gazetarët, me "paafësinë" e tyre për të mësuar një emër...

► vijon në faqen 16

DEMSPERBLIMET

Të përndjekurit ja emrat e rinj për këstin e tretë, Veliq: Gati i pesti

► FAQE 4-5



SPECIALE

Milan Shufraj, të panjohurat e dorëshkrimeve për shqiptarët

► FAQE 18-19



Blue Medical Center

Vizita, Analiza & Diagnostikim
Të garantuara sipas protokolleve të mjekësisë bashkëkohore nga Blue Medical Center

Të parandalosh, më mirë se të kurosh!

Adresa: Rruga "Bardhyl" Nr.101, Tiranë
Tel: + 355 4 2370 668
Cel: +355 66 20 90 008
Email: info@bmc.al, www.bmc.al

» 20 SHKURT '91

ISH-KRYEMINSTR Berisha dhe figurat me potencial në PD, nuk i janë bashkuar aktivitetit të organizuar nga kreu i selisë blu Basha me rastin e 20 Shkurtit

Lulzim Basha "braktiset" nga Berisha me 20 Shkurt

Kreu demokrat: Qeveria Rama-Meta në thelb është neohoxhiste

ERMIRA MRRUKU
TIRANË

Në 24-vjetorin e rrëzimit të përmendores së diktatorit Enver Hoxha, Partia Demokratike ka zhvilluar një aktivitet në qendër të Tiranës. Ajo që u vu re në një optikë të thjeshtë në këtë aktivitet ishte mungesa e liderit historik të së djathtës Sali Berisha në krah të kreut demokrat Lulzim Basha. Siç shihet ish-kryeministri Berisha vendosi të "braktisë" kreun demokrat në këtë 24 vjetor duke e lënë të lirë në abitatin e tij, në krye të aktivitetit dhe festimeve. Megjithatë kjo "braktisje" nuk rezultoi edhe aq pozitive për kreun e selisë blu, pasi edhe pse aktiviteti ishte lajmëruar disa ditë më parë, pjesëmarrja linte shumë për të dëshiruar. Të vetmit persona që i qëndruan "besnik" Bashës dhe e shoqëruan në 24-vjetorin e rrëzimit të përmendores së diktatorit Enver Hoxha, ishin punonjësit e bashkisë së Tiranës. Kjo ishte "risia" në 20 Shkurtin e këtij viti, dyndja masive e administratës së bashkisë për të qenë në krah të kreut të tyre Lulzim Basha. Kjo pasi edhe vetë deputetët e Partisë Demokratike e kishin bojkotuar këtë aktivitet në masë. Ndër ata të paktët deputetë të cilët ishin prezentë, ishin Edi Paloka, Tritan Shehu, Ardian Turku, Myqerem Tafaj dhe Albina Deda. Sikur të mos mjaftonte "braktisja" nga ish-kryeministri Berisha dhe e deputetëve të djathtë në 24 vjetorin e rrëzimit të përmendores së diktatorit, Bashën e "braktisën" edhe studentët e dhjetorit, prej të cilëve nuk evidentojmë asnjërin në këtë aktivitet.

AKUZA

Në fjalën e tij, gjatë aktivitetit, kreu demokrat Basha nuk i kurseu akuzat ndaj qeverisë aktuale, ndërsa hoqi paralele mes diktaturës së Enver Hoxhës dhe qeverisjes Rama-Meta. Ndërkohë duke hequr paralelet mes pushtetit aktual dhe diktaturës, ai e cilësoi qeverinë e sotme si një qeveri që në thelb të saj është neohoxhiste. "Qeveria aktuale është për të gjithë në këtu sot dhe për të gjithë sh-



Lulzim Basha dje në Sheshin "Skënderbej"

VIDEO/ 24 VJET NGA RRËZIMI I BUSTIT, BASHA I VETËM PA BERISHËN

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të AIREPORT që shkarkohet falas

Aktiviteti

Dhjetoristët festojnë të ndarë: kreu i PD-së nuk na ka ftuar

Festa në ditën e 20 Shkurtit, 24 vjetorit të rrëzimit të përmendores së diktatorit Enver Hoxha, u festua në dy kampe të ndara. Nga njëra anë patëm kreun demokrat Lulzim Basha, i cili festoi paraditen e djeshme 20 Shkurtin i ndjekur nga administrata e bashkisë së Tiranës. Nga ana tjetër studentët e dhjetorit të cilët aktivitetin e tyre në përkujtim të rrëzimit të përmendores së Enver Hoxhës e zhvilluan disa orë më vonë në Hotel Tirana, ku ishte parashikuar të merre pjesë edhe deputetja Mesila Doda, e cila për arsye personale nuk ka arritur të ishte në aktivitet. Ndërkohë që asnjëri prej dhjetoristëve nuk iu bashkua liderit të së

djathtës në këtë aktivitet, të pyetur se pse kishin zgjedhur të festonin veçmas, ata shprehën se nuk kanë marrë asnjë ftesë nga Basha për aktivitetin që ai organizoi. "Nuk kam pasur asnjëherë ftesë nga Partia Demokratike, edhe pse jam një nga themeluesit e Partisë Demokratike, kam pasur kontribut të madh në PD. PD-ja sot funksion jo mbi bazën e asaj që është krijuar, demokracia le shumë për të dëshiruar në atë parti" theksoi Ardi Stefa njëri prej themeluesve të PD-së. Megjithatë, dy prej

deputetëve demokrat, Edi Paloka dhe Tritan Shehu, të pyetur se pse ende vijonë të festojnë në dualitet me dhjetoristët në përvjetore të tilla, ata preferojnë të mos komentojnë shumë mbi këtë pjesë, duke lënë të kuptohet se kjo çështje është e koklavitur në brendësi të demokratëve. "Nuk di nëse ka një aktivitet tjetër për 20 Shkurtin, s'kam dijeni për këtë, unë shkoj në ato aktivitete që marr ftesa", shprehet kreu i grupit parlamentar të PD-së Edi Paloka. Ndërkohë që deputeti demokrat Tritan Shehu shprehet për këtë çështje "Di të them se secili feston në mënyrën e tij, në këtu ata atje, fundja kjo është demokracia".

Besojmë te forca e shembullit që kjo ngjarje ju përcjell brezave. Sot është koha të hedhim tutje modelin "Hoxhist" të idhtarëve të pushtetit absolut. Sot është koha të luftojmë kriminalizimin e politikë, është koha të çojmë Shqipërinë përfundimisht në Europë dhe ta cilirojmë



Studentët e '90-ës

cat për eliminim të opozitës, arrogancën dhe arbitraritetin e shkollës së vjetër

anti-demokratike. Besojmë në fuqinë e qytetarëve të lirë, si në 20 shkurt 1991.



Qendrimet

Berisha

"20 Shkurti i ri është thirrja e qindra mijëra shqiptarëve që përballen sot me terrorin e shtetit policor, terrorin e energjisë elektrike, taksave të larta, standartet më të ulta", shkruajti dje në "facebook" Berisha

Basha

"24 vjet më parë në hodhem përmendoren, sot duhet të ç'rrenjosim përgjithmonë rilindjen e modelit të diktaturës. Enver Hoxha dhe nipërit e tij politikë, nuk duhet të jenë pjesë e modeleve tona të qeverisjes".

Merkoçi

"Sot jemi pas 24 vjetësh këtu jo për të rrëzuar pushtetin, por për të rrëzuar ata që uzurpuan pushtetin. Në duhet të organizohemi në bazë të vlerave për të rrëzuar këtë sistem që është një diktaturë demokratike".

Shqipërinë nga e keqja", tha Basha. Ndërkohë të pranishmit e tjerë që morën pjesë në ceremoni thanë se i duhet thënë stop miteve të diktaturës, ndërsa kërkuan që në Kuvend të ketë një përfaqësi më të madhe të dhjetoristëve pasi ata janë përfaqësimi më i mirë i politikave.



Berisha, kundër grevës për rrëzimin e bustit të Hoxhës

I kishte dhënë fjalën Ramiz Alisë të mos krijonte shqetësime

Ish-kryetar
TIRANE

Berisha s'ka qenë dakord të bëhej greva e urisë së studentëve për heqjen e emrit të Enver Hoxhës nga Universiteti i Tiranës. Qëndrimi i tij ka qenë i prerë: Ishte çështje studentësh që të mos njihnin UT me këtë emër. Madje ai bën me dije se i kishte dhënë fjalën presidentit Ramiz Alia që të qëndronte larg me



PD për të evituar destabilizimin e vendit. Një fakt i tillë bëhet i ditur për herë të parë nga gazeta "Shqiptarja.com"

një ditë më parë, teksa zbardhi procesverbalin e mbajtur më 18 shkurt 1991 ditën e fillimit të grevës së urisë së studentëve për heqjen e emrit të diktatorit Enver Hoxha nga Universiteti i Tiranës, dhe vetëm dy ditë para se të rrezohet busti. Në procesverbal jepjen me detaje çfarë është thënë në mbledhjen e Komisionit Drejtues të PD më 18 shkurt 1991, ku në përfundim të saj është zgjedhur në krye të PD Sali Berisha duke zvendosur Azem Hajdarin dhe sekretar i përgjithshëm zgjidhet Eduard Selami. Pikërisht në këtë mbledhje është diskutuar për të qëndruar larg kësaj greve

për heqjen e emrit të Hoxhës nga muri i UT dhe për t'u marrë me organizimin e PD, pasi zgjedhjet e 31 marsit të atij viti ishin në prag. Shihet qartë dëshira e Berishës për të mos vepruar asnjëherë pa u konsultuar me Ramiz Alinë. Ndërsa Hajdari këmbëngul se studentët do ta fillojnë grevën e urisë pasi janë të distancuar nga PD. "Ne duhet të këmbëngulim që situata të qetësohet sa më shumë të mundet. T'ju sugjerojmë një rrugë të mesme, që të kthehen në auditorë. Vetëshpalleni se nuk e njihni emrin e Universitetit të Tiranës me emrin Enver Hoxha", thotë Berisha.

Përvjetori
TIRANE

Berisha te Ramiz Alia ditën e shembjes së bustit të Hoxhës

Meksi: Më 20 shkurt kur u rrëzua busti, kush ishte në shesh

Roli i Berishës ditën e rrëzimit të bustit të diktatorit të Enver Hoxhës më 20 shkurt të 1991 ka qenë i dyshimtë. Protagonistë të asaj dite të rëndësishme thonë se ish-kreu i PD dhe njeriu që ka dominuar politikën shqiptare për vite me radhë Sali Berisha s'ka qenë organizator as protagonist për rrëzimin e bustit dhe për më tepër ka qenë vetëm me një makinë FIAT të bardhë, që ka lënë pas hijen e interpretimeve të ndryshme herë si i dërguar i Ramiz Alisë për të mbikëqyruar lëvizjen e studentëve dhe të qytetarëve të Tiranës në sheshin "Skënderbej" herë se ka qenë në një makinë pa targa të Sigurimit të Shtetit. Por të gjithë bashkohen në një pikë: në momentin e rrëzimit të bustit Sali Berisha ka qenë në zyrën e ish-presidentit Ramiz Alia. "Kanë qenë tek sheshi sëpaku Ben Imami dhe Gon Çika, që u integruan në krye të turmës e sigurisht dhe të tjerë. Këtë e them pasi ishim bashkë të tre, na thirrën turmat, ndërsa unë ika sipër te studentët dhe ata vijuan me turmën. Ndërsa te studentët kam qenë vetëm unë atë ditë", ka thënë kohë më parë për gazetën tonë ish-kryeministri, njëri ndër protagonistët kryesorë të themelimit të PD, Aleksandër Meksi. Që ka nënvizuar se pavarësisht kërkesave për ta



Reagimi

Anti-mitingjet dhe tradhtia e PD solli grevën e studentëve

— PPSH reagoi me organizimin e antimitingjeve në çdo vend kundër mitingjeve të PD. Fillimisht ato u organizuan në zonat rurale, nëpër fshatra, aty ku në të vërtetë nuk kishte buste. Bustet që rrezoheshin nëpër qytete nisën të vendosen nëpër fshatra të ndryshme, ku era e komunizmit ishte ende shumë e fortë.

U krijua një situatë kaotike e mjaft e rrezikshme, që mund të precipitonte shumë shpejt në një konflikt të madh civil. Kuvendi miratoi një dekret më 23 janar 1991, ku parashikohet respektimi dhe mbrojtja e monumenteve që lidhen me historinë kombëtare dhe simboleve shtetërore, ku përfshihen busti i Enver Hoxhës. Sipas dekretit dënohej me 6 muaj deri në tre vjet burg ai shtetas,

që dhunonte monumente kulturore, siç ishin bustet e figurave të shquara, nga Skënderbeu deri te Enver Hoxha. "Studentët e përfunduan misionin e tyre, tani "ustallarët" do t'i japnin drejtim historisë". Të papërfilluar nga PD e në një situatë pasigurie, studentët filluan të ndjehen të tradhtuar dhe kjo çoi në një reagim të ri. Ata u organizuan, hynë në grevë për të shembur komunizmin dhe e bënë, teksa u rrezua busti i Enver Hoxhës, simbol i komunizmit.



Sali Berisha me Studentët e Dhjetorit '91

hore e do ti vijë radha më me nge". Por ai nënvizon faktin se rrugët që lidhnin rrugën e "Elbasanit" me bulevardin ishin të bllokuara nga forca të shumta policore dhe nga garda dhe për rrjedhojë shkohej në shesh ku ishte monumenti i diktatorit, kështu që u realizua ai rrëzim i bustit të diktatorit që ishte një fitore e atyre që bënë rrëzimin e komunizmit. Ndërkohë që një tjetër protagonist thotë se Berisha nuk ka qenë në shesh ditën e rrëzimit të bustit. "Berisha s'ka qenë në shesh për heqjen e bustit, madje është parë një makinë "FIAT" të dyshimtë dukë kaluar në

çaste kur po shkulej statuja. Pse nuk doli nga FIATI? Pse nuk iu bashkua popullit, por në fakt ka shkuar te zyra e Ramiz Alisë. Shkoi se kishte frikë? Shkoi se e e thirri Alia? Apo e çuan të raportojë? Nuk e di! Ai ishte aktiv dhe futej kudo. Njerëzit e donin. Ishte energjik. Këtë fakt e kam ditur, por nuk i kam dhënë shumë rëndësi, sepse Berishën, si shumë shqiptarë e adhurorim në vitet 90-të. Ishte lideri i së djathtës. Ashtu kujtonim. Berisha ka qenë me Pashkon te Piramida përballë Institutit 6, afër SHQUP-it. Aty ka kaluar një "Benz" i TVSH. Dhe Berisha e ka ndaluar benzin duke i

24-vjetori

Shembja e bustit të diktatorit Enver Hoxha më 20 shkurt 1991 shënoi rënien zyrtare të regjimit komunist. Dita në sytë e protagonistëve.

thënë shoferit: Do më çosh te shoku Ramiz", shkruan Robert Papa, gazetar asokohe dhe afër PD. Ai thotë se ka shumë mundësi që të ishte FIATI i djalit të diktatorit, Ilir Hoxha, asokohe drejtor i Institutit 6, me të cilin Berisha lëvizti drejt zyrës së Alisë.

hequr emrin e Enver Hoxhës nga Universiteti i Tiranës, meqenëse ishte në fushatë

PD Berisha kishte thënë që "s'merremi tani me këtë punë pasi jemi në fushatën zgjed-

DRAFTI i qeverisë për hapjen e dosjeve i bazuar në modelin gjerman, do të vijë këtë javë në Kuvend për tu bërë pjesë e diskutimit në komisionet parlamentare

Qeveria sjell javën tjetër në Kuvend, ligjin për dosjet

Niko Peleshi dhe Veliaj japin detaje mbi ligjin, ja çfarë parashikon mazhoranca me draftin e saj

JUXHIN MUSTAFARAJ
TIRANE

Projektligji i qeverisë për hapjen e dosjeve do të bëhet pjesë e diskutimeve këtë javë në komisionet parlamentare në Kuvend. Konfirmimin për këtë e dha dje nga qyteti i Shkodrës në një takim me ish-të përndjekurit, Ministri i Mirëqenies Sociale, Erjon Veliaj. Sipas ministrit, krahas iniciativës së qeverisë për hapjen e dosjeve janë edhe i mijë ish-të përndjekur politikë të Shkodrës të cilët janë angazhuar dhe kanë nënshkruar një peticion për hapjen e dosjeve. Ministri vlerësoi modelin e propozuar nga qeveria, pasi sipas tij është bazuar në modelin gjerman dhe nuk është thjesht çështje parash. "Javën tjetër nis në parlament shqyrtimi i projektligjit për hapjen e dosjeve të regjimit. Kemi ndjekur modelin më të mirë, atë gjerman. Kjo nuk është vetëm çështje paresh. Nuk duhet të ketë vetëm kompensim ekonomik për të përndjekur por edhe kompensim moral", tha Veliaj. Sipas ministrit në kushtet kur e gjithë shoqëria ka vullnet për hapjen e dosjeve, nuk është e nevojshme që kjo të realizohet me një ligj për lustracionin. "Këto ligje personale i bënte kush i bënte përpara 8 vitesh", u shpreh Veliaj. Pjesë e takimit me ish të përndjekurit, ishte edhe zv.kryeministri Niko Peleshi i cili u shpreh se hapja e dosjeve është një proces i tejzgjatur dhe të përndjekurit janë përdorur politikisht. "Si përfaqësues i politikës ndihem keq që për një çerek shekulli s'kemi arritur t'i zgjidhim këto çështje. Zvarritja ka qenë e qëllimshme dhe një lojë e shëmtuar politike, por ne kemi vullnetin dhe seriozitetin për t'i zgjidhur ato njëherë e mirë. Është koha që të ndërtojmë një raport të ri me të shkuarën, i cili domosdoshmërisht kalon nga zgjidhja e këtyre çështjeve si një detyrim moral për të vendosur drejtësi e për të bërë transparencë", u shpreh Peleshi. Sipas zv.kryeministrit zvarritja e këtyre çështjeve është një njollë për klasën politike të tranzicionit. Ndërkohë që


e konsideroi zgjidhjen e tyre një vendosje të drejtësisë që do të na lejojë të ecim përpara të dhe një çlirim nga komplekset e së shkuarës.

DRAFTI

Qeveria ka gati draftin për hapjen e dosjeve, të cilin pritet ta sjellë në

komisionet parlamentare, ndërkohë që paralelisht me këtë draft është dorëzuar edhe ai i deputetëve Mesila Doda dhe Shpëtim Idrizi. Drafti i propozuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Erjon Veliaj, është i mbështetur në modelin gjerman, ndërkohë që

drafti i deputetëve Doda dhe Idrizi është më radikal dhe i hartuar në bashkëpunim me shoqërinë civile. Në këtë draft parashikohet që të largohen nga detyra edhe ministra, prokurorë dhe drejtues të lartë të cilët kanë pasur funksione të larta gjatë sistemit komunist.



Drafti i qeverisë për hapjen e dosjeve i dorëzuar në Kuvend

Ministri
Sipas ministrit në kushtet kur e gjithë shoqëria ka vullnet për hapjen e dosjeve, nuk është e nevojshme që kjo të realizohet me një ligj për lustracionin



Niko Peleshi në Shkodër

Peleshi
Hapja e dosjeve detyrim ndaj shoqërisë
Kemi seriozitetin dhe vullnetin për t'i zgjidhur njëherë e mirë këto çështje. Është koha të ndërtojmë një raport të ri me të shkuarën. Hapja e dosjeve është detyrim ndaj shoqërisë dhe sëbashku me demshpërblimin ekonomik ato do t'i japin fund kalvarit të vuajtjeve të kësaj shtrese. Qëndrimi i qeverisë është parë si sfida nga shoqëria civile e cila ka dorëzuar një tjetër draft.

TË PËRNDJEKURIT
Ministri: Brenda marsit kësti i pestë



— Ministri Veliaj gjatë takimit me ish të përndjekurit në Shkodër, njoftoi shpërndarjen e këstit të pestë për këtë kategori brenda muajit mars. "Më vjen mirë që përtej fjalëve ne kemi patur disa rezultate konkrete dhe fakti që për ata që janë gjallë ka filluar kësti i katërt dhe brenda marsit fillon kësti i pestë do të thotë që qeveria kur do të bëjë diçka e bënë atë. Nëse qeveria do kishte dashur që 8 vitet e kaluar ti jepte paratë skish asnjë arsye që të mbetej në një këst", tha Veliaj.

Hapja e Dosjeve

Doda: Projekti i qeverisë nuk qartëson pastrimin e figurave

— Debatimi për hapjen e dosjeve dhe ligjin e Lustracionit pritet të marrë shumë kohë në Komisionet Parlamentare. Çështja më e debatuar politikisht gjatë 24 viteve të fundit pritet të ndezë debatin politik në tre Komisionet Parlamentare, në atë të Ligjeve, në Komisionin e Sigurisë dhe të Çështjeve Sociale. Kjo jo vetëm për shkak të impaktit që ka kjo çështje por edhe për shkak se në Kuvend janë depozituar dy projekte, një nga qeveria dhe tjetri nga shoqëria civile, e firmosur nga deputetët Mesila Doda dhe Shpëtim Idrizi. Në një intervistë për "A1 Report" deputetja Mesila Doda thotë se ndonëse dy projektet i referohen shembullit gjerman ato ndahen në mënyrën se si të trajtohet Lustracioni për largimin nga postet drejtuese të personave

që kanë shërbyer gjatë regjimit komunist. "Ne i kemi kërkuar një lustracion por shoqëria gjermane lustracionin e ka bërë deri në nivelin e arsimtarëve. Drafti i qeverisë nuk parashikon lustracionin, drafti parashikon marrje informacioni lidhur me këto persona, me këto çështje për të cilat kemi folur" tha Doda. Sipas saj, projektligji i qeverisë u jep mundësinë parlamentareve të qëndrojnë në detyrë. "Duhet t'i bëjnë thirrje ndërgjegjes së tyre, persona që nuk kanë skelete në të kaluarën e tyre, persona që nuk kanë mëkate në të kaluarën e tyre ata duhet të shfaqen dhe ta japin me votën e tyre, mendimin e tyre. Ato të cilët nuk do japin vendim për këtë çështje, janë persona të cilët do të dëshirojnë të mbeten të lidhur me të kaluarën" tha Doda.



Mesila Doda

Dëshmëpërblimet

LORENC RABETA
TIRANE

Ministria: Gati kësti i tretë për 40 ish të përndjekur

Drejtorja: Të plotësohet dokumentacioni për tërheqjen e shumave

Drejtorja e Pagesave dhe Dëshmëpërblimeve ka bërë publike listën e 40 ish të përndjekurve të cilëve u është miratuar kësti i tretë po që duhet të plotësojnë dokumentacionin për të tërhequr shumat. "Lista e ish të dënuarëve të cilat janë ende gjallë të cilët duhet të marrin këstin e tretë, duhet të paraqesin dokumentet pranë Ministrisë së Financave" thekson dikasteri në dokumentin sqarues. Ministria e Financave ka bërë publike emrat e përfutuesve, bashkë me numrin e dosjes, vendimin e Këshillit të Ministrave i cili i ka njohur të drejtën e dëshmëpërblimit, numrin personal të llogarisë bankare si dhe bankën ku do t'i kalohen shumat.

PAGESA

Sipas Ministrisë, pagesat do të kryhen për të gjithë trashëgimtarët e ish të dënuar politik. Trashëgimtarët duhet të dorëzojnë dokumentet e kërkuara sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë trashëgimtarët e ish të dënuar duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë, që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëshmëpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, Emër/Mbiemri, apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së

identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile.

TË DHËNAT

Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës

apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjyqate që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative. "Në rastet kur ish- i përndjekuri nuk jeton më, një dosje quhet e rregullt dhe e gatshme për tu paguar, vetëm atëherë kur të gjithë trashëgimtarët pa përjashtim, do të kenë dorëzuar (postuar) dokumentacionin e përmendur më lart për të gjitha rastet e trashëgimisë. Në të kundërt, askush nuk mund të paguhet i veçantë, derisa i gjithë dokumentacioni i dosjes të jetë i plotë për të gjithë", thekson Ministria.



Njoftimi

Ministria ka bërë publike emrat e përfutuesve, bashkë me numrin e dosjes, numrin personal të llogarisë bankare si dhe bankën ku do t'i kalohen shumat

LISTA E ISH TE DENUAREVE TE CILAT JANE ENDE GJALLE QE DUHET TE MARRIN KESTIN E TRETË

Emri	Mbiemri	Atesi
Tomë	Pemaj	Filip
Brahim	Hazizaj	Hysen
Pal	Dedaj	Mark
Latif	Bekteshi	Abdullah
Vasil	Cacanis	Panajot
Fazlli	Doko	Ismail
Myrret	Tatolaku	Nefail
Loli	Diamandi	Ilija
Nazmi	Berisha	Mehmet
Isuf	Dautaj	Vesel
Lube(Ljube)	Panov	Jane
Dhimiter	Papa	Vasil
Zek	Shala	Tahir
Karafil	Isufaj	Mahmut
Fier	784	X
Avdi	Cani	Mustafa
Emrulla	Ymeraj	Ymer
Mehmet	Shuti	Avdi
Dëshir	Çizmja	Fadil
Rasim	Nelaj	Qazim
Taisa	Batkina (Pisha)	Aleksander
Hajdar	Fregjal	Zenel
Nuredin	Bresho	Meçan
Beqir	Ibraj	Dan
Ibrahim	Ibrahimaj	Ali
Hajredin	Xhunga	Jaup
Flamur	Karagjozi	Neshet
Imedi	Biba	Idris
Sali	Peca	Selman
Selim	Jusufo	Zenel
Preng	Marku	Mark
Mustafa	Elez	Sali
Kastriot(Kosta)	Bardhi	Marko(Mark)
Ded	Shkemi	Binak
Odhise	Çollu	Kosta
Nikoll	Hasaj	Prek
Sulejman	Mamica	Islam
Kosta	Kapsalidhi	Jorgo
Ilirjan	Çelaj	Elez
Xhevdet	Pashaj	Muharrem
Ziso	Angjeli	Stavro
Remzi	Bojku	Aziz


Lefter Koka takon Ferid Aganin, mbrojtja mbi Liqenin e Fierzës

Bashkëpunim për Parkun e Alpeve Shqiptare. Hartimi i planit

Kurum ul koston me impiant

Mbetjet përfundojnë në lumin Shkumbin

— "Kurum" mbetet ende shqetësimi i banorëve dhe i zonave përreth. Territori i cili ndodhet pranë ish-kombinatit metalurgjik në Elbasan, duket thajse si i vdekur. Ndotja e këtij qyteti vjen nga grirja dhe përpunimi i skrapit dhe skorjeve të hedhura nga kompania "Kurum" çdo ditë. Vendosja e impiantit të skrapit është vetëm benefiti që merr Kurum-i, por pasojat e tij i ka mjedisi dhe banorët, të cilët prej vitesh jetojnë me ndotjen që ai shkakton. Gjithçka përfundon vetëm në një vend. Në ujërat e tij i ka mjedisi dhe banorët, të cilët prej vitesh jetojnë me ndotjen që ai shkakton. Gjithçka përfundon vetëm në një vend. Në ujërat e tij i ka mjedisi dhe banorët, të cilët prej vitesh jetojnë me ndotjen që ai shkakton. Gjithçka përfundon vetëm në një vend. Në ujërat e tij i ka mjedisi dhe banorët, të cilët prej vitesh jetojnë me ndotjen që ai shkakton.



kudo. Banorët të cilët prej vitesh jetojnë përreth ish-kombinatit ku ushtron aktivitetin edhe Kompania Kurum, janë ata që ekspozohen drejtpërdrejt me ndotjen. Të gjithë aty po vuajnë nga kanceri dhe të gjitha pasojat e tij i përballojnë në dyert e spitaleve, pasi shëndeti i tyre është infektuar për gjithë jetën.



Ministri i Mjedisit, Lefter Koka ditën e djeshme është takuar me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Kosovës, Ferid Agani. Gjatë këtij takimi, diskutimet u bënë mbi bashkëpunimin aktual në fushën e mjedisit mes dy vendeve, duke u ndalur në çështjet e parbashkëta të mjedisit. Gjatë këtij takimi u theksua vëmimi i bashkëpunimit për shpalljen e Parkut



Lefter Koka gjatë takimit me Ferid Agani

të Alpeve Shqiptare dhe hartimin e planit të tij, gjatë vitit 2015-të, si edhe për finalizimin e shpalljes së zonës ndërkufitare të mbrojtur

trëpalëshe, me Kosovën dhe Malin e Zi. Pas diskutimeve të tyre paraprake, Ministri Koka i dorëzon homologut të tij kërkesën për përkrahjen dhe

angazhimin e Ministrisë së Mjedisit në dhënien e statusit mbrojtës Liqenin të Fierzës dhe dhe pellgut Ujëmbledhës së tij. Kjo kërkesë e Ministrisë së Mjedisit të Shqipërisë, u mbështet nga ana e Ministrisë së Mjedisit të Kosovës. Gjithashtu, gjatë fjalës së tij, Ministri Koka theksoi se të gjitha Parqet Kombëtare, zonat e mbrojtura, Monumentet e Natyrës të Shqipërisë dhe ato të Kosovës të bëhen të aksesueshme nga qytetarët e të dy vendeve. Në përfundim të këtij takimi, të dy Ministrat, Koka dhe Agani shprehën angazhimin e tyre të plotë të Shqipërisë dhe të Kosovës, për të bashkëpunuar në të gjithë sektorët e mjedisit për një zhvillim sa më të qëndrueshëm mes të dy vendeve.

» LUMI VJOSE

DEPUTETI socialist Besnik Baraj thekson se ministria e Jashtme shqiptare duhet të reagojë qartë për të mbrojtur interesin kombëtar, në lidhje me pretendimin grek për devijimin e lumit Vjosa

Greqia vendos në mars për devijimin, Baraj: MPJ të reagojë!

Deputeti i PS: Nuk është e drejtë që pala greke të marri vendime në kurriz të palës shqiptare

ARBËR HITAJ
TIRANE

Këshilli i shtetit grek ose Gjykata Supreme Administrative në shtetin fqinj, do të vendosë në muajin mars për fatin e lumit Vjosa që kalon në Shqipëri. Kjo gjykatë ka në dorë fatin e Lumit Vjosa, veçanërisht për pjesën shqiptare. Gjykata do të vendosë në mars nëse lumi Vjosa do devijohet ose jo dhe nëse kjo ndodh, lumi do devijohet drejt Liqenit të Janinës duke e "zhdukur" rrjedhën e tij në pjesën shqiptare, që është edhe gjatësia më e madhe e lumit. Në seancën e fundit mes palëve avokati i qeverisë greke, bëri një deklaratë që mund të fshehtë një aferë të rëndë në dem të interesit kombëtar. Sipas avokatit Ministria e Jashtme shqiptare e drejtuar nga Aldo Bumçi, është informuar në korrik të 2013 dhe se argumenti i paditësve se nuk është informuar pala shqiptare nuk qëndron. Avokati ka nënvizuar se qeveria e atëhershme shqiptare është njoftuar me anë të një letre zyrtare, por letra është refuzuar të publikohet nga avokati në sallën e gjyqit. Vendimet e qeverisë greke janë marrë një në 8 korrik 2013 nga 9 ministri greke dhe një në datën 9 shtator 2013 nga Këshilli Kombëtar grek për menaxhimin e lumenjve, ku është parashikuar devijimi i lumit Vjosa në qarkun e Epirit. Deputeti i Partisë Socialiste Besnik Baraj duke folur për A1Report, thotë se duhet një reagim i qartë nga autoritetet shqiptare dhe nga Ministria e Jashtme për të mbrojtur interesin kombëtar, pasi një projekt që ka efekte zinxhir në Shqipëri, nuk mund të merret pa dakordësinë e Tiranës zyrtare. "Ne duhet të bëjmë pjesën tonë, i takon të gjitha institucioneve shtetërore përfshi dhe parlamentin të luaj rol in e vet në këtë drejtim, minimalisht të ketë informacionin e domosdoshëm dhe të dobishëm e cila garantohet nga vetë konventa e Espos dhe që ne të mbajmë qëndrimin përkatës pastaj ku ekspertët dhe politikanët bërësit dhe institucionet përkatëse qeveritare të luajnë atë rol që duhet të luaj në këtë rast në mënyrë që të mbrojmë interesat e palës shqiptare, sigurisht jo në kurriz të palës greke, por dhe ata kurrësi nuk është e drejtë që të marrin vendime



Besnik Baraj

Konventa Espos

"Ne duhet të bëjmë pjesën tonë, i takon të gjitha institucioneve shtetërore përfshi dhe parlamentin, minimalisht të ketë informacionin e domosdoshëm dhe të dobishëm e cila garantohet nga vetë konventa e Espos dhe që ne të mbajmë qëndrimin përkatës".

VIDEO/ DEVIJIMI I VJOSËS, GREQIA VENDOS NË MARS

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të A1REPORT që shkarkohet falas

Kërkesë për anulim është bërë nga:


1. E WWF HELLAS me qendër në Athinë
2. E Entit të menaxhimit të parqeve kombëtare Vikos-Aoos dhe Pindit
3. E Shoqatës ambientalistë jufitimprurëse KALLISTO
4. E shoqatës jofitimprurëse MED-INA
5. E Bashkisë Konicë
1. Ministrinë që kanë apvotuar projektin e devijimit. Ministrin të Mjedisit, Energjitikës dhe ndryshimeve klimatike
2. Ministrin të Jashtëm
3. Ministrin të Financave
4. Ministrin të Brendshëm
5. Ministrin të Zhvillimit dhe Konkurrencës, infrastrukturës, Transportit dhe rrugeve.
6. Ministrin të Arsimit
7. Ministrin të Kulturës dhe Sportit
8. Ministrin të Shëndetit
9. Ministrin të Zhvillimit Bujqësor dhe ushqimeve

në kurriz të palës shqiptare", tha deputeti socialist Baraj. Ndërkohë, Besnik Baraj hedh poshtë edhe një tjetër pretendim të qeverisë greke, se në Shqipëri nuk ka autoritet që merret me çështjen e ujërave,

prandaj nuk ka pasur kërkesa për trajtim të hollësishtëm të devijimit të Vjosës. Sipas Barajt në Shqipëri janë disa institucione që merren me këtë çështje. Deputeti socialist shkon më tej, duke argumentuar se



NË FOTO: (lart) Harta e cila tregon rrjedhën e lumit Vjosa që buron në malin Mavrovouni dhe vazhdon në drejtim të veriperëndimit për në Shqipëri. (poshtë) Lumi Vjosë në rrjedhën e tij në tokën shqiptare, i cili nëse devijohet nga shteti fqinjë rrezikon të mos ekzistojë më në këtë rrjedhë



E drejta juridike

"Nuk besoj që pala greke do të marri një vendim i cili shkel një aspekt të rëndësishëm ndërkombëtar, juridik dhe hyn në konflikt me një të drejtë legjitime të palës shqiptare. Pasi në jemi në të gjithë të drejtën juridike ndërkombëtare për ta kundështuar këtë projekt".

qoftë Greqia qoftë Shqipëria dhe shumë vende të tjera janë palë, gjë që sjell një precedent shumë negativ i cili mund të pasojë me zhvillime të tjera, qoftë në palën shqiptare ku mund të dëmtohet pala greke dhe atë frymë bashkëpunimi dhe atë klimë marrëdhënies të fqinjësisë së mirë. Gjë që është do thosha e patolerueshme dhe unë nuk besoj që pala greke do të marri një vendim i cili shkel këtë aspekt kaq të rëndësishëm ndërkombëtar, juridik dhe hyn në konflikt me një të drejtë legjitime të palës shqiptare. Pasi në jemi në të gjithë të drejtën juridike ndërkombëtare për ta kundështuar këtë projekt", tha deputeti Baraj.

VENDIMI

Vendimi për devijimin e lumit Vjosa është marrë nga 9 ministri Greke, dhe nga Këshilli Kombëtar i Ujërave. Qëllimi i devijimit është ndërtimi i një hidrocentrali me kapacitet të lartë prodhues. Në padinë e ngritur nga

Vendimi për devijimin e lumit Vjosa është marrë nga 9 ministri Greke, dhe nga Këshilli Kombëtar i Ujërave. Qëllimi i devijimit është ndërtimi i një hidrocentrali me kapacitet të lartë prodhues. Në padinë e ngritur nga



Reagimi i Bumçit:

“Qeveria të sqarojë nëse ka folur për Vjosën me Greqinë”

Pas deklaratës së avokatit të qeverisë greke i cili në lidhje me projektin për devijimin e Vjosës ka argumentuar se politika shqiptare është informuar që në kohën kur Ministër i Jashtëm ishte Aldo Bumçi, ky i fundit ka reaguar duke thënë se përgjegjësitë për këtë marrëveshje i ka qeveria e cila duhet të saktësojë çdo bisedim që është bërë me palën greke. Ish ministri i jashtëm Aldo Bumçi ka reaguar për A1 report në lidhje me lajmin e devijimit të lumit Vjosa duke thënë se këto janë çështje që duhet të zgjidhen në bashkëpunim mes 2 vendeve dhe jo në mënyrë të njëanshme. Deputeti demokrat, Aldo Bumçi tha se s'ka rëndësi se kur ka ardhur letra nga pala greke, por sipas tij e rëndësishme është që ministria e Jashtëm të japë sqarime se për çfarë ka folur me palën greke, ndërsa i referohet vizitës së Venizellos në



vendin tonë. “Ministria duhet të japë informacion në lidhje me punën që ka bërë për të zgjidhur këtë çështje. Ministria e jashtëm të japi llogari. Ish ministri i jashtëm grek Venizellos ka ardhur 2 herë në Tiranë”, tha ish-ministri i Jashtëm, Aldo Bumçi. Megjithatë ish-ministri i Jashtëm Bumçi nuk saktësoi se kur ka mbërritur letra në Ministrinë e Jashtëm, letër që sipas të cilës avokati i qeverisë greke ka thënë se ministria e Jashtëm shqiptare e drejtuar nga Aldo Bumçi, është informuar në korrik të 2013 dhe se argumenti i paditësve se nuk është informuar pala shqiptare nuk qëndron. Avokati ka nënvizuar se qeveria e atëherëshme shqiptare është njoftuar me anë të një letrë zyrtare. Qeveria greke përdor si argument kryesor për devijimin e Vjosës pikërisht informimin e palës shqiptare, çfarë sipas palës greke lë hapësirë për zhvillimin e projektit.

← organizatat joqeveritare argumentohet se në radhë të parë janë shkelur ligjet ndërkombëtare pasi ky është një lum që kalon në 2 shtetet dhe pala shqiptare nuk është pyetur me argumentimin se nuk janë zgjedhur përfaqësuesit e institucionit të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Ujërave dhe pushteti

lokal nuk funksionon. Gjithashtu në padi thuhet se devijimi i lumit, krijon edhe probleme të mëdha natyrore, me florën dhe faunën e zonave ku kalon. Edhe në Shqipëri ka pasur reagime të forta të ambientalistëve dhe shoqata për mbrojtjen e Vjosës, që i kanë kërkuar qeverisë shqiptare reagim sa më të shpejt.

PËRSHKRIMI

Lumi rrjedh nga malet e Pindit në lindje të Janinës, kurse burimi gjendet në malin Mavrovouni. Rrjedha e tij vazhdon në drejtim të veriperëndimit për në Shqipëri. Lumi ka një gjatësi prej rreth 272 km, prej të cilave 80 km në territorin e Greqisë, kurse rreth 192

km brenda territorit të Shqipërisë. Ekspertët e mjedisit thonë se devijimi i lumit do të sillte pasoja katastrofale për ekosistemin shqiptar. Madje sipas tyre një veprim i tillë do të ishte i dëmshëm për bujqësinë në zonën e Myzeqesë, pasi do të thante gjithë kanalin Vjosë-Levan-Fier, duke shkatërruar

sistemin e vaditjes në zonën e Fierit dhe Lushnjes. Prurjet mesatare në grykëderdhje janë rreth 204 m³/s. Në muajin prill prurja është rreth dhjetë herë më e madhe se në gusht. Devijimi i Vjosës ka krijuar shqetësime edhe në Greqi, ku një eurodeputet grek e ka çuar çështjen edhe në Parlamentin Evropian.

LUMI I VJOSËS



Ja si nisi dhe u zhvillua idea e devijimit të lumit Vjosë

Si është njohur pala shqiptare në lidhje me këtë projekt të shtetit helen

Ku konsiston ekzaktësisht devijimi i Vjosës nga Pala greke?

Lumi Vjosa e fillon rrugëtimin e tij pranë fshatit Vuvusa në veriperëndim të Greqisë dhe vazhdon rrjedhën natyrale në jug të Shqipërisë, drejt Detit Adriatik. Ndërkohë në territorin grek kalon vetëm 70 km e gjatësisë së tij. Projekti parashikon që 70 milionë metër kub ujë, të devijohet çdo vit nga burimi i lumit të Vjosës. Diga që është menduar të ndërtohet sipas projektit, parashikon një fund të papritur të udhëtimit të lumit në Vuvusë. Sipas këtij projekti të palës greke synohet devijimi i ujërave me anë të një dige të re.

Kur dhe si është njohur pala shqiptare në lidhje me këtë projekt të shtetit helen?

Pala jonë është njohur nëpërmjet reagimeve që vetë përfaqësuesit e politikës greke kanë bërë në parlamentin evropian. Vetë deputetët grek kanë qenë ata që kanë bërë me dije në korrik të 2013 se Greqia e kishte firmosur tashtë projektin për të devijuar Vjosën.

Si është pritur ky vendim i qeverisë greke në lidhje me këtë projekt?

Faktikisht nga asnjëra palë nuk është pritur mirë pasi: pala greke, eurodeputetët kanë thënë se ky është një projekt i paarsyeshëm dhe destruktiv pasi projekti i firmosur nga pala greke për devijimin e lumit Vjosë është edhe i paligjshëm. Përsa i përket palës shqiptare fillimisht ajo nuk ka reaguar fare që në momentin e parë kur u hodh si ide në Parlamentin Evropian, por reagimet kanë nisur të vijnë pas firmosjes së këtij projekti në korrik të 2013.

Kjo do të thotë që ka kaluar mjaftueshëm kohë nga nisja e idesë deri në firmosjen e projektit nga pala greke.

Në fillim kjo u mor vetëm si një ide e çmendur dhe askush nuk e besoi njësoj sikurse ndodhi edhe me devijimin e Radikës. Të parët që kanë nisur çdo reagim kanë qenë qytetarët. Për rastin e Vjosës banorët të shumtë të zonave në të cilat kalon Vjosa ishin ata që u ngritën të parët por edhe ambientalistët të cilët kanë reaguar duke thënë se nëse ndodh ajo që është projektuar atëherë pjesa më e madhe e Vjosës e cila kalon në territorin shqiptar do të humbasë.

Por a nuk ekziston një konventë ndërkombëtare në lidhje me përcaktimin e ujërave ndërkombëtare?

Në Konventën mbi Përdorimin e Ujërave Ndërkombëtare, shkruhet se Lumenjtë të cilët kalojnë në dy a më shumë vende, këto vende kanë njësoj të drejta të barabarta për të përdorur ujërat e tij dhe nuk mund të ndërmarrin asnjë veprim për të ndërhyrë në rast se nuk ka miratimin e palës tjetër. Po ashtu kjo konventë parashikon se nuk mund të merren vendime që nuk trajtojnë njësoj të dyja vendet që kanë të drejtën e shfrytëzimit të kësaj pasurie.

Andikoni devijimi i Vjosës në ekosistem?

Ka një ndikim të madh pasi edhe shkalla e devijimit është jashtëzakonisht shumë e madhe nëse marrim parasysh prurjet. Devijimi i Vjosës do të thotë që të mos “ekzistojë” më ky lum për territorin shqiptar në të cilin ka gjatësinë më të madhe.

FLORINDA MERKO

Kur ka nisur ideja për devijimin e lumit Vjosë?

Shqipëria është njohur me këtë projekt-ide shumë vonë pasi fillimisht kishte zëra se do të merrej një vendim për devijimin e Vjosës dhe asgjë më shumë. Por shteti fqinj, Greqia që është edhe ideuesi i projektit për devijimin e lumit Vjosë dhe jo vetëm, ka nisur që më 31 korrik të 2013 me një VKM që i shkon për shtat pasurimit të hidrografisë së vendit të tyre. Më 31 korrik të 2013 Ministria e Transportit dhe Ministria e Mjedisit në Greqi nënshkruan një projekt, ku parashikohet devijimi i lumenjve në veri të Greqisë për pasurimin e liqenit të Janinës. Në listë është edhe lumi i Vjosës, gjatësia e të cilit në territorin grek është 70 km.

A kishte patur më parë informacion për këtë pretendim të palës greke?

Fillimisht kur kanë nisur zërat e parë për këtë projekt, Shqipëria ishte në fazën që sapa kishte përfunduar ratifikimin e marrëveshjes së përcaktimit të kufijve detar me Greqinë pas debateve të shumta për ndryshimin e tyre. Në dhjetor të 2012 një nga eurodeputetët grekë Nikos Krisogelos ngriti pyetjen nëse vendet e BE kishin apo jo të dhëna për një plan të Greqisë lidhur me devijimin e lumit Vjosë nga rrjedha e tij normale.



KQZ miraton raportin, i jep fund pretendimeve për referendum

Kostoja e zgjedhjeve vendore 2015 do të jetë 743 mln lekë

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka dhënë fund pretendimeve të disa komunave dhe bashkive për zhvillimin e referendumeve, lidhur me reformën territoriale. Në mbledhjen e djeshme, KQZ miratoi raportin për vitin 2014 në të cilin ishte i përfshirë edhe vendimi i Kolegjit Zgjedhor për rrezimin e vendimit të KQZ-së që i kishte dhënë të drejtë njësisë administrative të

zhvillonin referendume. Në mbledhjen e djeshme është miratuar edhe pagesa për dy audituesit e zgjedhjeve, që do të marrin në total 120.000 lekë për periudhën 3 mujore që do të angazohen në proces. Ndërkohë që KQZ ka parashikuar edhe buxhetin 743 milion lek, shumë e cila e ndarë në zëra do të mbulojë të gjitha shpenzimet për zgjedhjet vendore të 21 qershorit. Një shumë prej 279,5 milion lekë do

të akordohen për pagat e punonjësve mes tyre komisionerë e numërues që do të punojnë ditën e zgjedhjeve. 240 milion lekë llogariten sipas KQZ-së për kutitë, fletët e votimit, bojën matrikuluese dhe kodet e sigurisë. 223 milion të tjera do të shkojnë për ambientet e votimit dhe numërimin me qera, transportin e materialeve dhe reklamën nëpër media.

→ **"3 vjetori"**

Ministria e Mbrojtjes përkujton Feti Voglin



Ministria e Mbrojtjes ka përkujtuar djete vjetorin e rënies në detyrë të Dëshmorit të Atdeut, Kapitenit Feti Vogli. Në ceremoninë e zhvilluar merrnin pjesë, Ministria e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, e shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo dhe komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku. Gjatë fjalës së saj, Ministria e Mbrojtjes Kodheli theksoi se, 20 shkurti është një ditë për t'u nderuar dhe gjithkush e kujton atë në mënyrë të ndryshme, por një gjë kemi të përbashkët: "Krenarinë që na jep lavdia e misionit që përmbushim për ditë, misioni kushtetues dhe human, më i drejti, më i forti, ai i vënies në rrezik të jetës së gjithsej prej jush për paqen dhe sigurinë edhe në një vend tjetër, ashtu siç Kapiten Vogli ra. Kjo duhet të na mbush me krenari, jo vetëm juve, por dhe fëmijët tuaj dhe fëmijët e fëmijëve tuaj. Ju përmbushni një mision që s'ka të krahasuar, u shpreh Kodheli. Ministria vlerësoi maksimalisht edhe Forcat e Armatosura, duke theksuar se pavarësisht tentativave për të bërë pis emrin e FA, ata vijojnë të na bëjnë krenar për atë që përfaqësojnë. "Forcat e Armatosura Shqiptare janë krenare për gjithçka bëjnë në emër të atdeut, të lirisë dhe paqes. Ata janë të paprekura nga askush që këtë Forcë kërkon ta bëjë pis dhe kërkon t'ia ulë kokën. Këtë e them, sepse thellë nga zemra më dalin vetëm ca fjalë: Ju lumtë për çka përfaqësoni, ju lumtë për çka bëni. Ne do mbetemi kurdoherë në respekt të asaj që ju çdo ditë bëni bashkë me kolegët tuaj. Ju jeni pjesë e Batalionit Special. Ju duhet t'i tregoni vetes dhe gjithkujt se jeni vërtetë më të mirët, ju jeni forca speciale. Ne mundohemi që dinjitetin tuaj ta bëjmë më të fortë e më të qëndrueshëm", deklaroi Kodheli.

Mazhoranca e opozita bëhen bashkë për procesin e integritimit

Drafti i deputetëve, Majlinda Bregu merr drejtimin e Këshillit

JUXHIN MUSTAFARAJ
TIRANE

Mazhoranca dhe opozita kanë vendosur të gjejnë gjuhën e përbashkët për procesin e integritimit evropian. Apelit të ndërkombe të ministres së Integritimit Evropian, Klajda Gjosha për ngritjen dhe fillimin nga puna të Këshillit Kombëtar të Integritimit, opozita i është përgjigjur vetëm pasi ka arritur të marrë drejtimin e këtij këshilli. Kështu në projektligjin e depozituar në Kuvend, me kërkesë të deputetëve Taulant Balla, Majlinda Bregu dhe Ke-

BASHKËPUNIMI
Integrimi pritët të jetë e vetmja fushë në të cilën mazhoranca dhe opozita do të kenë qëllime të përbashkëta mes tyre, kjo edhe falë ndihmës të dhënë nga BE

jdji Mehmetaj është përcaktuar ngritja e Këshillit dhe lënia e drejtimin të tij ish-ministres së Integritimit, deputetes demokratike Majlinda Bregu. Në projektligjin për "Rolin e Kuvendit në procesin e integritimit të Shqipërisë në BE", bëhet e qartë se Këshilli Kombëtar i Integritimit do të jetë struktura kryesore që do të bashkërendojë punën mes Kuvendit dhe gjithë instancave europiane për ecurinë e vendit drejt BE-së. "Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian është struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin evropian që ngrihet pranë Kuvendit, i cili nxit dhe garanton bashkëpunimin gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe siguron rritjen e transparencës në vendimmarrjen për çështjet e integritimit", thuhet në draftin e dorëzuar në Kuvend. Pjesë e këtij këshilli do të jenë: drejtuesit e Komisioneve Parlamentare, ministrin e integritimit, përfaqësues të kryeministrit, presidentes, kryeprokurorit, shoqërisë civile etj. Pranë Kuvendit do të funksionojë edhe një strukturë tjetër, Komiteti Parlamentar për Stabilizim dhe Asociim. Kjo strukturë do të jetë një strukturë e përbashkët mes Kuvendit dhe Parlamentit Evropian. Ai do të përbëhet nga anëtarë të Kuvendit dhe Parlamentit Evropian dhe në fokus të tyre do të kenë diskutime dhe takime lidhur me integritimin, për të cilat më pas raportojnë edhe në Kuvend. Integrimi pritët të jetë e vetmja fushë në të cilën mazhoranca dhe opozita do të kenë qëllime të përbashkëta mes tyre, për aq kohë sa edhe drejtimin e Këshillit Kombëtar të Integritimit ja besuan opozitës.

STRUKTURAT PËRGJEGJESE PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

Neni 6
Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian

- Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian është struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin evropian që ngrihet pranë Kuvendit, i cili nxit dhe garanton bashkëpunimin gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe siguron rritjen e transparencës në vendimmarrjen për çështjet e integritimit.
- Këshilli Kombëtar i Integritimit drejtohet nga Kryetari i Komisionit Parlamentar të Integritimit. Zëvendës kryetar është kryesuesi i delegacionit shqiptar në Komitetin Parlamentar për Stabilizim dhe Asociim.
- Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian përbëhet nga:
 - Kryetari e Komisioneve të përbashkëta parlamentare;
 - Ministri përgjegjës për integrimin;
 - Përfaqësues nga Kabineti i Presidentit;
 - Përfaqësues nga Kabineti i Kryeministrit;
 - Prokurori i Përgjithshëm;
 - Zëvendës kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
 - Avokati i Popullit;
 - Përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile të përfshira në çështjet e integritimit evropian.
- Në takimet e Këshillit Kombëtar të Integritimit Evropian marrin pjesë me statusin e të ftuarit të përhershëm:
 - titullarët e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj, që raportojnë dhe informojnë Kuvendin;
 - Përfaqësues nga Akademia e Shkencave dhe Universiteti Publik;
 - Përfaqësues nga media;
 - Përfaqësues nga organizatat e biznesit dhe dhomat e tregtisë;
 - Përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe të trupit diplomatik.
- Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian, sipas tematikës së takimit, flon të marrin pjesë edhe ministrat përgjegjës dhe/ose institucionet e varësishë.
- Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian organizon takime periodike.

Projektligji

Këshilli

Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian është struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin evropian që ngrihet pranë Kuvendit

Drejtimi

Në projektligjin e depozituar në Kuvend, është përcaktuar ngritja e Këshillit Kombëtar të Integritimit dhe lënia e drejtimin të tij deputetes Majlinda Bregu

Faksimile e draftit të propozuar në Kuvend nga deputetët Majlinda Bregu, Taulant Balla dhe Kejdji Mehmetaj lidhur me rolin e Kuvendit në procesin e integritimit

Letër për 3 deputetët e Le Pen

Balla: Mos godisni ëndrrën europiane të Shqipërisë

Deputeti socialist Taulant Balla i është kundërpërgjigjur letërës që tre deputetët francez të Le Pen dorëzuan në Kuvend për të kundërshtuar anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Balla në cilësinë e kryetarit të Delegacionit në Komitetin Parlamentar të Stabilizim dhe Asociimit BE-Shqipëri, është

shprehur në letërën e tij për deputetët francezë se të përjashtosh Shqipërinë është llogari meskine. "Të përjashtosh Shqipërinë, thjesht për të shtuar një pikë më shumë në listën e gjatë të manifesteve për deshtimin e Europës të së ardhmës, është një llogari fort meskine, me një çmim ndoshta shumë

të lartë. Shqipëria, zinxhiri i historisë në distancë të njejtë midis Romës dhe Stambollit mban çelësat gjeopolitikë të Lindjes dhe Perëndimit dhe përbën elementin moderues të një rajoni historikisht të trazuar. Ëndrra europiane e Shqipërisë nuk ka nevojë për tu goditur", shkruan në letër Balla.

VENDIMI Përfitojnë 6.3 miliardë lekë ujësjellësit, 373 milionë lekë spitalet, 302 milionë lekë shkollat, 171 milionë lekë komuna të ndryshme, 172 milionë bordet e kullimit, etj

GENC KONDI
TIRANE

Qeveria ka vendosur këto ditë një tjetër amnistë për borxhet e ndërsjellta të krijuara në sektorin shtetëror për faturat e energjisë. Me anë të një VKM-je, Këshilli i Ministrave "ka shuar" detyrime të krijuara në periudhën 2007-2014 midis institucioneve shtetërore dhe kompanive KESH e OSHEE, si dhe midis KESH-it dhe ministrisë së Financave, në masën 8 miliardë lekë në total. Vendimi është marrë pas propozimit të ministrit të Energjisë dhe Industrisë dhe të ministrit të Financave. Këshilli i Ministrave konkretisht ka vendosur miratimin e shuarjes, me kompensim, të detyrimeve të krijuara, të njohura dhe rakorduara mes palëve, sipas përcaktimeve të mëposhtme. Institucionet buxhetore dhe institucionet që financohen nga buxheti kanë rakorduar detyrimet e energjisë elektrike, në kolonën "total debi e pranuar", të krijuara deri më 31.12.2014. Këto detyrime ndaj shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., do të shuhen deri në vlerën 8 miliardë lekë. OSHEE, sh.a.-ja, në cilësinë e kreditorit, ka dhënë tashmë pëlqimin për këtë shuarje.

Ndërkohë, edhe detyrimet e krijuara deri më 31.12.2014, të OSHEE, sh.a.-së, ndaj KESH, sh.a.-së, për energjinë e lëvruar nga KESH, sh.a.-ja, për furnizimin e konsumatorëve tariforë, do të shuhen deri në 8 miliardë lekë.

Dhe, së treti, detyrimet e krijuara deri më 31.12.2014, të KESH, sh.a.-së, ndaj Ministrisë së Financave, për huatë e marra nga KESH, sh.a.-ja, për të cilat Ministria e Financave ka hyrë në marrëdhënie nënhuazimi, garancie shtetërore apo kredidhënieje, do të shuhen deri në vlerën 8 miliardë lekë. Pas përfundimit të veprimeve kontabël, të gjitha institucionet e varësisë njoftojnë titullarët e tyre për shumën e detyrimit të shuar dhe mbylljen e llogarive. Titullarët e ministrive/institucioneve qendrore, që kanë në varësi institucionet, njoftojnë Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministrinë e Financave për shumën e detyrimit të shuar për çdo institucion varësie. Bashkitë dhe komunat njoftojnë ministrin e Shtetit për Çështjet

Qeveria fal 57 mln € detyrime të faturave të energjisë elektrike

"Shuhen" borxhe te institucionet buxhetore të periudhës 1 janar 2007 - 31 dhjetor 2014

Vendore, Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministrinë e Financave për shumën e detyrimit të shuar për çdo institucion varësie.

Vendimi ka hyrë në fuqi menjëherë. Nga ai përfitojnë afro 6.3 miliardë lekë për detyrime ujësjellësit, 373 milionë lekë të reja spitalet, 302 milionë lekë shkollat, 171 milionë lekë

komuna të ndryshme, 172 milionë lekë bordet e kullimit, 51 milionë lekë burgjet, 52 milionë lekë komisarariatet e policisë, 100 milionë lekë repartet ushtarake, etj.

komuna të ndryshme, 172 milionë lekë bordet e kullimit, 51 milionë lekë burgjet, 52 milionë lekë komisarariatet e policisë, 100 milionë lekë repartet ushtarake, etj.

Lista e detyrimeve të kontratave buxhetore dhe jobuxhetore

Periudha Janar 2007 - Dhjetor 2014. Sipas sistemit të faturimit datë 31.12.2014

■ Borde Kullimi	48	41,691,902	130,781,573	172,473,476
■ Burgje	18	8,435,052	43,323,558	51,758,610
■ Cerdhe	88	6,558,015	7,901,861	14,459,876
■ Komisariate	134	23,940,251	28,186,823	52,127,074
■ Komuna	619	87,313,253	83,523,559	170,836,812
■ Konvikte	49	8,507,346	9,621,955	18,129,301
■ Kopshte	361	14,454,264	21,180,961	35,635,225
■ QST	43	98,407,460	81,199,149	179,606,608
■ Reparte	227	50,258,680	49,814,187	100,072,868
■ Shkolla	1847	152,374,064	149,050,000	301,424,064
■ Spitale	1281	160,793,981	212,196,779	372,990,760
■ Ujësjiellës-Pompa	1017	3,011,418,593	3,249,501,656	6,260,920,248
Grand Total	6,459	3,799,794,020	4,200,205,981	8,000,000,000



Shuma e detyrimeve të KESH ndaj Ministrisë së Financave

PËRSHKRIMI	TOTAL DETYRIMI NË LEKË
■ Për marrëveshjet e nën huave	1,192,329,576,37
■ Për marrëveshjet me garanci shtetërore	6,655,483,31
■ Për financim buxhetor	8,000,000,000,00

Investimet në shpërndarjen e energjisë

Mars 2015, OSHEE fillon instalimin e matësve inteligjentë

— Instalimi i matësve inteligjentë do të nisë që nga muaji i ardhshëm në utostradën Tiranë-Durrës, më pas në zonën e Bathores, Alliasit dhe zonën së tregut të Medreseja. Gjithsej janë 10 mijë matës që do të instalohen. Në njoftimin për shtyp të kryeministrit thuhet se "Deutsche Telekom ka marrë përsipër zbatimin e projektit pilot për instalimin e 10 mijë matësve inteligjentë në disa zona të Tiranës". Në planin e investimeve për këtë vit, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) planifikon të instalojë 53 mijë matës të rinj, nga të cilat 13 mijë në zonën e Bathores dhe Paskuqanit dhe pjesa tjetër prej 40 mijë matësish në rajonet e tjera të vendit. Burimet në Minis-

trinë e Energjetikës bëjnë me dije se, zonat informale janë të patrajuara me investime dhe mungojnë tërësisht matësit. Rrjeti i shpërndarjes në këto zona është shumë i dobët për shkak edhe të lidhjeve të jashtëligjshme. Ndaj këtë vit zonat informale do të jenë në qendër të vëmendjes si për arkëtimet dhe investimet. OSHEE planifikon deri në fund të vitit 2016 të instalojë mbi 300 mijë matës, të cilët do të blihen nga kredia e Bankës Botërore. Kjo do të bëjë të mundur që të gjithë konsumatorët të pajisën me matës të rinj që të masin saktë. Por Ministria e Energjetikës mendon se, për të sjellë në parametra normal rrjetin e shpërndarjes në vend i duhen fonde për afërsisht një miliardë dollarë.



Teknologjia

Plan për heqjen e telave të telefonisë e internetit

■ Kablot ajrore e vendosura nëpër pallate, shtëpi apo rrugë nuk do të mbahen më në mënyrë të tillë, deklaroi dje ministria e Inovacionit, Milena Harito, gjatë prezantimit të projektplanit për rregullimin e infrastrukturës kablore të telefonisë fikse dhe internetit, që aktualisht janë të zhvilluara në mënyrë të pakontrolluar dhe jashtë një planifikimi. Për kreun e AKEP, Pirro Xhixho, fibra optike po merr gjithmonë e më shumë rëndësi, por infrastruktura e trashëguar nxjerr në pah probleme.

Lame: 60 ditë afat për pronësinë e trojeve në bregdet

Deklarimi do të jetë i mundur në një afat që nis nga data 23 shkurt deri 24 prill 2015

LORENC RABETA
TIRANE

Të gjithë qytetarët që kanë blerë në bregdet apartamente nga subjekte ndërtues të cilët nuk kanë pronësi mbi truallin kanë 60 ditë kohë në dispozicion për të aplikuar për blerjen e tij. Lajmi është bërë dhe publik nga kreu i ALUIZNI-t Artan Lame, sipas të cilit, rezultoni se një pjesë e madhe e subjekteve ndërtues dhe qytetarëve të interesuar, nuk kanë mundur të bëjnë vetëdeklarimet brenda afatëve të përcaktuara, dhe si rrjedhim nuk mund të procedojnë më tej për fitimin e pronësisë së truallit. "Të gjithë qytetarët që kanë blerë në bregdet apartamente nga subjekte ndërtues të cilët nuk kanë pronësi mbi truallin, të



■ Apartamentet

Sipas Artan Lames, nga evidenti faktik, rezultoni që deri tani të kenë aplikuar 91 subjekte me rreth 1200 apartamente që përfshihen në këtë kategori

paraqiten pranë zyrave tona, për të aplikuar për këtë qëllim", tha Lame në një dalje përpara medieve.

1200 APARTAMENTE

Sipas Lames, nga evidenti faktik, rezultoni që deri tani të kenë aplikuar 91 subjekte me rreth 1200 apartamente që përfshihen në këtë kategori. Por nga ana tjetër, janë edhe disa qindra subjekte, me rreth 4 deri në 5 mijë apartamente të ndërtuara dhe të shitura qytetarëve, të cilët nuk mund t'i regjistrojnë këto prona, sepse nuk kanë mundur t'i deklarojnë sipas ligjit të vitit 2009. Këto apartamente gjenden të ndërtuara kryesisht në zonat e Velipojës, të Gjirit të Lalzit, dhe pjesa masive në plazhet e Golemit dhe të Malit të Robit. "Pikërisht për t'i hapur rrugë zgjidhjes së problemit të kësaj

5 mijë
Janë edhe disa qindra subjekte, me rreth 4 deri në 5 mijë apartamente, të cilët nuk mund t'i regjistrojnë këto prona



Artan Lame

mase qytetarësh, po rihapim edhe procesin e deklarimeve të tyre. Deklarimi do të jetë i mundur në një afat prej 60 ditësh, prej ditës së hënë dt. 23 shkurt deri më 24 prill 2015" tha Lame.

BREGDETI

Një nga dështimet më të

dukshme të politikave ekonomike në këtë vend në gjithë këtë çerek shekulli, theksoi Lame, është edhe dështimi jetëgjatë i zhvillimit të zonave të stimuluar turistike në bregdetin shqiptar. "Ky proces krijoi një situatë absurde ku, nga njëra anë shteti njihje vetëm pak qindra subjekte

të cilëve u kishte dhënë të drejtën të ndërtonin fshatra dhe struktura turistike, që nuk funksionuan asnjëherë dhe, nga ana tjetër ishin mijëra e mijëra qytetarë që i kishin blerë këto apartamente, por pa pasur asnjë të drejtë ligjore mbi to" shpjegoi Lame.

SHKELJA E LIGJIT

70 mijë USD gjobë Kompanisë së naftës

Doganat penalizojnë subjektin "Phenix" 78.937 kg naftë bruto gati për treg

Një kontroll i administratës doganore në kompaninë "Phenix" ka zbuluar një sasi prej 78.937 kg naftë bruto, e gatshme për tu hedhur për tregtim në kundër-

për tu hedhur për tregtim. Specialistët e Departamentit të Akcizës, bazuar në nenin 4 pika 2 germa b dhe nenin 91 pika 4 dhe 9, e Ligjit 61/2012 "Për Akcizat" (të ndryshuar), e kanë klasifikuar shkëljen e mësipërme si shkëlje administrative dhe e kanë penalizuar subjektin në shumën 6,920,275 lekë. Nga këto detyrimi i munguar është 1,973,425 lekë dhe penaltiteti në shumën 4,946,850 lekë" theksoi Drejtorja e Përgjithshme e Doganave në një njoftim për shtyp. Drejtorja e Përgjithshme e Doganave dhe Departamenti i Akcizës kërkojnë të informojnë publikun dhe operatorët ekonomikë se kontrollat në këtë fushë do të vazhdojnë në mënyrë intensive për të siguruar fiskalitetin e produkteve të akcizës dhe mbrojtjen e interesit publik, theksoante më tej deklarata.



kontrolli i ushtruar në ambientet e kompanisë "Phenix" (kompani që operon në fushën e nxjerrjes së naftës bruto), u konstatuan një tepëricë prej 78.937 kg naftë bruto, e gatshme



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT

AGJENCIA E LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TE ZONAVE / NDERTIMEVE INFORMALE
DREJTORIA E ALUIZNI-T TIRANA (4)

NJOFTIM

MBI PARAQITJEN E KËRKESËS PËR KALIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË, MBI TRUALLIN E NJËSISË SË NDËRTUAR, NË ZONAT ME PËRPARËSI TURIZMIN.

Personat e stimuluar / subjektet e interesuar, të cilët kërkojnë kalimin e të drejtës së pronësisë mbi truallin e njësisë së ndërtuar, në përputhje me ligjin nr.10186, datë 05.11.2009 "Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin", i ndryshuar, të paraqesin pranë Drejtorisë së ALUIZNI-t, Tirana (4), brenda 60 ditësh dokumentacionin e mëposhtëm:

A. Kur kërkesa bëhet nga Subjekti i Interesuar

1. Kërkesën për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi truallin, të plotësuar sipas formularit tip të miratuar nga ministri përgjegjës;
2. Kontratën e lidhur me personin e stimuluar për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi njësinë e ndërtuar;
3. Planimetrinë dhe sipërfaqen në m² të njësisë së ndërtuar;
4. Dokumentet e pronësisë për njësinë e ndërtuar, nëse ka;
5. Kopje të dokumentit të identifikimit ose ekstrakt të regjistrimit tregtar.

B. Kur kërkesa bëhet nga Personi i Stimuluar

1. Kërkesën për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi truallin, sipas formularit tip të miratuar nga ministri përgjegjës;
2. Marrëveshjen e qirasë apo të zhvillimit, të lidhur ndërmjet personit të stimuluar dhe qiradhenësit, nëse është lidhur një marrëveshje e tillë;
3. Lejen e ndërtimit dhe/ose lejen e sheshtit të ndërtimit;
4. Projektin arkitektonik të miratuar;
5. Dokumentet e pronësisë për njësinë e ndërtuar, nëse ka;
6. Kopje të dokumentit të identifikimit ose ekstrakt të regjistrimit tregtar;
7. Vërtetimin nga Agjencia Kombëtare e Turizmit për detyrimet e marrëveshjes së qirasë, të logaritura deri në momentin e zgjidhjes së marrëveshjeve.
8. Vendimin e organeve kompetente për dhënien e titullit personi i stimuluar, nëse nuk kanë lidhur marrëveshje zhvillimi.

Tarifa e aplikimit është 2 500 lekë, pagesa mund të shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë.
Adresa: Rr"Dora D'Istria", Tiranë

Intervista



LORENÇ RABETA
TIRANE

Një intervistë për Gazetën "Shqiptarja.com", kreu i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Ilirjan Muho flet për rolin e institucionit në procesin e legalizimeve si dhe në pajisjen me tituj pronësie të 12 mijë apartamenteve për rreth 400 pallate në Tiranë. Muho shpjegon efektet që ka dhënë përfundimi i regjistrimit fillestar të pasurive në gjithë territorin, falë të cilit ZRPP ka ofruar 800 mijë shërbime për qytetarët, 200 mijë prej të cilave në zyrën e Tiranës.

Zoti Muho, doja ta nisim bisedën me procesin e regjistrimit fillestar të pronës i cili është zvarritur prej vitesh duke penguar veprimet me pasuritë të paluajtshme në shumë pjesë të territorit shqiptar. Çfarë veprimesh bllokonte zgjatja e këtij procesi dhe në ç'pikë është aktualisht?

Bllokimi në ka përjetuar për vite me radhë çdo qytetar që paraqitet në sportele për të kryer veprime të çfarëdoshme, që nga transaksionet me pronën, deri të regjistrimi, por që merrte përgjigjen se ajo zonë nuk është përfshirë ende në sistem. Është e vërtetë që ka pasur një zvarritje të ndjeshme të procesit të regjistrimit fillestar të pasurive. Procesi, i financuar nga Bankës Botërore, përbëhet nga dy komponentë. I pari është regjistrimi i rreth 400 mijë pasurive në zona urbane dhe sub-urbane në disa zona kryesore kadastrale në gjithë territorin shqiptar, i dyti ka të bëjë me instalimin e sistemit elektronik të regjistrimit në dhjetë zyrat kryesore të republikës. Duhet thënë se procesi nuk është sipas planit dhe u shtua dy herë. Në shtator të vitit 2013, nga 400 mijë pasuritë, në total qenë regjistruar vetëm 160 mijë, ndërkohë që sistemi elektronik që regjistruar vetëm në 5 nga dhjetë zyrat ku duhet të qe instaluar. Që nga shtatori, 2013 deri në qershor 2014, arritëm të regjistrojmë në total 320 mijë pasuritë të paluajtshme, falë angazhimit të të gjithë aktorëve të përfshirë në proces duke zhblluar edhe ngërcin për qytetarët. Por ç'është më e rëndësishme, nga 10 zyrat ku parashikohej të instalohesh sistemi elektronik, u arrit të instalohesh në 35 Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në gjithë Territorin. Pra nëse për gjashtë vite qenë regjistruar vetëm 160 mijë pasuritë, për të njëjtën zyrë u regjistruan dhe 160 mijë të tjera, ndërkohë që sistemi elektronik u instalua në gjithë territorin. Më tej, e vazhduam projektin me financimin tonë, duke bërë që numri i pasurive të regjistruara në fund të vitit 2014 të arrijë në 370 mijë.

Si është përkthyer kjo në shërbimin që i ofrohet qytetarëve?

Është shumë e rëndësishme të theksohet fillimisht që regjistrimi fillestar dhe sistemi elektronik kanë bërë të mundur ofrimin e një shërbimi cilësor, duke luftuar drejtpërdrejtë korrupsionin. Për të ilustruar efektin që ka

Hipotekat




Shërbimet

Falë sistemit elektronik dhe përfundimit të regjistrimit fillestar, gjatë vitit që kaloi ZRPP-të në nivel republike ofruan në total 800 mijë shërbime



Legalizimet

Përmes një qarkoreje të brendshme është përcaktuar se procedurat për dhënie dhe përgjigje për statusin e pronës për legalizim nuk mund të zgjasë më shumë se 3 ditë



Hipotekimet

Gjatë gjithë këtyre muajve ka pasur një numër të madh aplikimesh nga ana e ndërtuesve. Vetëm vitin e shkuar në qytetin e Tiranës u regjistruan 12 mijë apartamente

pasur në dobi të qytetarëve po nënvizoj se gjatë vitit që kaloi zyrat tona në nivel republike ofruan në total 800 mijë shërbime. Vetëm zyra e Tiranës për vitin që kaloi realizoi më shumë se 200 mijë shërbime për qytetarët. Në janarin e këtij vit regjistruam 90 mijë aplikime, nga 60 mijë të regjistruara në janarin e vitit të shkuar.

Kam përshtypjen se ky numër aplikimesh duhet të lidhet dhe me proceset në të cilat ZQRPP luan rol të dorës së parë, siç është ana e legalizimeve. Mund të na shpjegojmë në mënyrë specifike cili është roli i institucionit tuaj në këtë proces masiv dhe veçanërisht sa kohë zgjat shqyrtimi i një dosjeje legalizimi nga ana e ZQRPP?

ALUIZNI

Së pari ALUIZNI kërkon nga ne të dhëna mbi statusin juridik të pronave. Pasi merr përgjigjen nga ne ALUIZNI procedon me përgatitjen e lejes së legalizimit

Procesi i legalizimeve të ndërtimeve pa leje varet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në dy momente. Së pari ALUIZNI kërkon nga ne të dhëna mbi statusin juridik të pronave që janë objekt shqyrtimi të zyrave rajonale. Pasi merr përgjigjen nga ne ALUIZNI procedon me përgatitjen e lejes së legalizimit. Momenti i dytë ka të bëjë me regjistrimin e pasurisë pasi ALUIZNI përfundon procedurat e jep



Ilirjan Muho

Muho flet për rolin e institucionit në procesin e legalizimeve si dhe në pajisjen me hipoteka të 12 mijë apartamenteve në Tiranë

400 pallate në Tiranë, Muho: gati 12 mijë hipoteka

Flet Kreu i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme: Legalizimet brenda tre ditëve

lejen e legalizimit. Për ta bërë sa më të lehtë këtë proces masiv në zyrën e Tiranës dhe në disa të tjera, kemi vënë burime njerëzore tërësisht në funksion të ALUIZNI-t. Këta specialistë janë vënë tërësisht në dispozicion të ALUIZNI-t dhe trajtojnë vetëm dosjet e dërguara për legalizim. Numri i madh i legalizimeve të realizuara gjatë këtyre muajve është edhe rezultat i zyrave rajonale të regjistrimit të Pasurive ku procesi nis me verifikimin e statusit të pronës dhe përfundon me regjistrimin e saj. Sa për kohën e nevojshme për shqyrtimin e një dosjeje, përmes një qarkoreje të brendshme kam përcaktuar se procedurat për dhënie dhe përgjigje për statusin e zgasës për legalizim nuk mund të zgjasë më shumë se tre ditë. Ajo që vërejmë është se shpesh qytetarët tregojnë një farë neglizhence për të kryer regjistrimin pas përgatitjes së lejes nga ALUIZNI.

Ndërkohë që kemi pasur gjatë gjithë këtyre viteve edhe një problem tjetër të lidhur me regjistrimin e pasurive të paluajtshme, atë që në gjuhën e përditshme e quajmë hipotekim. Vetëm në Tiranë numëroheshin rreth 400 pallate, të përfunduara prej vitesh por pa u dhënë mundësi banorëve të merrnin certifikatat e pronësisë. Situata është në kufijtë e absurdes pasi banorët i kishin paguar paratë për blerjen e apartamenteve, por nuk qenë në gjendje t'i hipotekonin.

Është një shqetësim që na është ngrihur nga një numër i madh qytetarësh.

Problemi është se ne e kemi të pamundur të veprojim, kryesisht në rastin e objekteve të ndërtuara në Tiranë. Është detyrim i subjektit ndërtues, i cili pasi merr lejen e shfrytëzimit dhe të përdorimit nga njësi përkatëse vendore, të procedojë në zyrat tona me regjistrimin e pallateve. Megjithatë gjatë kësaj kohe kemi marrë kontakte të drejtpërdrejta me shoqatën e ndërtuesve që ndërtuesit të kryejnë procedurat, të plotësojnë dosjet e të paraqiten pranë zyrave tona për të regjistruar objektet. Vetëm pas këtij procesi qytetarët mund të kenë në dorë titujt e pronësisë së këtyre apartamenteve.

Përse ka ardhur kjo situatë?

Së pari për shkak të vonesave nga ana e njësisë vendore në dhënie e

E vërteta është që ngërci është zhblluar pas kontakteve të vazhdueshme me shoqatën e ndërtuesve dhe pas lehtësimit të procedurave për t'ua lehtësuar kompanive procesin e regjistrimit. Gjatë gjithë këtyre muajve kemi pasur një numër të madh aplikimesh nga ana e ndërtuesve, për rrjedhojë edhe të regjistrimit të apartamenteve për qytetarët. Vetëm vitin e shkuar në qytetin e Tiranës u regjistruan 12 mijë apartamente. Janë 12 mijë familje që pas vitesh të gjata pritjeje tashmë kanë në dorë titullin e pronësisë.

Ndërkohë ekziston një numër i konsiderueshëm i këtyre apartamenteve të cilët mbeten pa hipotekuar pasi firmat që i kanë ndërtuar kanë falimentuar, apo nuk ekzistojnë më.

Është dhe ky shqetësim. Qytetarëve u themi të paraqiten nëpër njësitë përkatëse vendore për të gjetur zgjidhje.

Nuk ekziston një numër në të detyruar nxitur ndërtuesit apo njësitë vendore për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për t'i hapur udhë regjistrimit të këtyre objekteve?

Realisht ekziston një vakuum ligjor në këtë proces. Ajo që mund të them si titullar i ZQRPP është se në rastin kur ndërtuesit na paraqiten me gjithë dokumentacionin e nevojshëm, titujt për qytetarët nxirren nga ne brenda jo më shumë se 4 ose ditë.

NEGLIZHENCA

Ajo që vërejmë është se shpesh qytetarët tregojnë një farë neglizhence për të kryer regjistrimin pas përgatitjes së lejes nga drejtoritë e ALUIZNI-t

lejeve të shfrytëzimit dhe akteve të kolaudimit, por edhe për shkak të neglizhencës së kompanive ndërtuese në plotësimin e dosjeve dhe në paraqitjen e tyre në zyrat tona për regjistrim.


Ndërkohë që e pësojnë qytetarët të cilët për vite e vite nuk kanë arritur të hipotekojnë banesat të cilat i kanë paguar sipas kontratave me ndërtuesit...

Filip Çakuli, padi Sali Berishës në gjyq i kërkon vetëm 1 lekë

Ish-kryeministri e akuzoi drejtuesin e "Fiksit" si gjobëvënës

ELTON QYNO
TIRANE

Ish-kryeministri Sali Berisha paditet në gjykatën e Tiranës gazetari i mirënjohur Filip Çakuli, i cili është drejtori i emisionit investigativ "Fiks-Fare". Çakuli ka marrë shkak nga një deklaratë e bërë para pak ditësh nga Sali Berisha në Kuvendin e Shqipërisë, ku ai sipas gazetarit i ka cënuar dinjitetin dhe moralin dhe për pasojë, drejtori i "Fiks-Fare", ka zgjedhur që të kërkojë dëmshpërbllim financiar për shpifjet e Sali Berishës. Shuma që Filip Çakuli, kërkon nga Sali Berisha është vetëm 1 lekë, shumë kjo simbolike, por nëse pranohet nga gjykata, detyrohet që Sali Berisha të paguajë në cilësinë e të dënuarit Filip Çakulin, me 1 lekë. I kontaktuar në telefon nga gazeta "Shqiptarja.



Filip Çakuli



Sali Berisha

com" Filip Çakuli ka pohuar se kishte depozituar padinë civile kundër Sali Berishës, për shkak të një shpifje të bërë nga Berisha në parlament dhe ka treguar edhe

arsyen e shumë qesharake që ai ka kërkuar si dëmshpërbllim nga ish-kryeministri. "Para pak ditësh Berisha tha në parlament se emisioni "Fiks Fare" (Filipi), ka nisur

një investigim për naftën por e mbylli. E dyta ai vazhdoi të thotë se Filipi është "gjobaxhi", dhe të dyja këto i ka thënë në parlament dhe deklarata e tij është trans-

metuar drejtpërdrejt në televizione. Unë nuk dua dëmshpërbllim shumë të madh, prandaj kam vënë dhe atë shifër qesharake. Mjafton që të ballafaqohemi me Sali Berishën në gjykatë e të paraqesë dokumenta dhe vendimi i gjykatës të jetë që Sala, ja fut kot gjatë fjalimit në parlament", deklaroi Çakuli. Dosja civile është rregjistruar në sekretarinë e gjykatës në datën 19 shkurt 2015, ndërkohë që në objektin e saj të padisë thuhet: "Detyrimi i të paditurit Sali Berisha ti shpërblejë paditësit Filip Çakuli dëmin jopasuror në shumën 1 lekë". Ndërkohë që gjyqtari i zgjedhur meshtortin elektronik për gjykimin e kësaj dosje është Kastriot Gramshi. Pritet që shumë shpejt gjykata të nisë procesin gjyqësor me palë Çakuli dhe Sali Berisha, ndërkohë që nuk dihet nëse Berisha do paraqitet ose jo në gjykatë.

➔ 100 mijë euro

Eno Bushi, paditi Berishën për çështjen e Rifortatos



■ Në muajin Maj të 2014 juristi Eno Bushi së bashku me bashkëshorten e tij Joana Bushi, kanë depozituar një padi civile kundër Sali Berishës, dukë kërkuar shpalljen fajtor të tij dhe detyrimin për ti shpërbleyer paditësat me vlerën financiare 100 mijë euro. Sipas çiftit Bushi, Berisha në deklaratimet e tij ka shpifur disa herë duke i akuzuar ata se kishin fshirë të dhëna e informacione, lidhur lëvizjet e pilotit Italian Rifortato të arrestuar nga prokuroria për trafik droge.

DERI NË 28 SHKURT JU MUND TË ULNI

-80%
KAMATËVONESËN

ose ta shtrini borxhin duke paguar çdo muaj **2500 lekë** mbi faturën korrente.



OSHEE 
www.oshee.al

Arrestimi

ELTON QYNO
TIRANE

Kryeinspektori Hamëz Demushi është arrestuar nga agjentët e SHKB, në ambientet e shtëpisë së tij, ku dhe i është sekuestruar një sasi prej 3,6 kilogramë kokainë, 0,5 gramë heroinë dhe disa pajsje që shërbenin për paketimin e lëndës narkotike. Demushi, në datën 2 deri në 5 shkurt të këtij viti është certifikuar nga drejtuesit më të lartë të Policisë dhe misionit PAMECA, si specialist dhe si agjent infiltrues. Mirëpo pa kaluar shumë kohë nga ky certifikim, Hamëz Demushi ka rënë në pranga, pasi kolegët e tij kishin pikasur se Demushi merrej me aktivitet kriminal. Fillimisht hetimet për këtë çështje kanë nisur rreth shpenzimeve të tepërta që kryente ky agjent policie i Grupit Operacional Special dhe më pas ka rezultuar se ai këto të ardhura i siguronte nga aktiviteti i shitjes dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike në Tiranë, por jo vetëm. Nga përgjimet e kryera dhe provat e administruara në banesën e agjentit të policisë, është vërtetur se sasinë e drogës Demushi e trafikonte nga Kosova dhe më pas e shpërndante në zona të ndryshme të Tiranës. Veç sasisë së drogës të sekuestruar, është faktuar se Hamëz Demushi, ka pasur në banesën e tij dhe mjetet me të cilat presonte

Polici kapet me 3.6 kg kokainë të fshehur në pilaf

Hamëz Demushi prangoset në flagrancë. Agjenti trafik kokaine nga Kosova në Shqipëri



Hamëz Demushaj

Droga në shtëpinë e Hamëz Demushaj

kokainën dhe që më pas e paketonte atë. Kokaina prej 3,6 kilogramë është kapur brenda një kutie të mbushur me pilaf, ndërkohë që brenda saj ishte e vendosur dhe një mostër për ta provuar.

TRAFIKU NË KOSOVË

Hamëz Demushi, dyshohet se është pjesë e një grupi kriminal që vepron nga Shqipëria në Kosovë. Për të hedhur dritë mbi emrat e personave të tjerë të implikuar në këtë ngjarje, prokuroria

ka marrë në pyetje Demushin duke i kërkuar bashkëpunim, por ky i fundit nuk ka pranuar të tregojë. Agjenti i policisë, ka pasur shumë numra kontakti të kompanive të ndryshme shqiptare por edhe kosovare, të cilët thashmë janë pjesë e verifikimit. Ndërkohë që në skaner janë dhe gjashtë aparatet celular të sekuestruar nga prokuroria. Hamëz Demushi, është ndjekur prej disa kohësh nga kolegët e tij, ndërkohë që teksa ata kanë hyrë në banesë, Demushit i kanë sekuestruar dhe disa kontrata-porositje për blerjen e apartamenteve në Tiranë dhe prova të tjera të dyshimita. Dyshimet e prokurorëve flasin se Hamëz Demushi mund të ketë lidhje me grupin e kokainës së Xibrakut, por kjo pjesë mbetet për tu verifikuar. Ndërkohë që oficeri mund të jetë përdorur edhe si korrier nga grupet kriminale.

OPERACIONI

Sekuestrohet, prova bindëse në banesën e Demushit



— Në banesën e Hamëz Demushit është gjetur dhe sekuestruar me cilësinë e provës materiale një sasi lëndës narkotike prej 3,6 kg e dyshuar e llojit kokainë, dhe 0,5 kg e dyshuar heroinë. Gjithashtu janë sekuestruar: 1 presë që shërbenete për presimin e lëndës narkotike, 2 kompjuterë Lap-top, 6 telefona celularë dhe mbi 30 karta SIM të kompanive celulare shqiptare dhe kosovare si dhe një sasi e madhe dokumentacioni, si akte shitjeje apartamentesh dhe automjete, si dhe dokumenta të tjera të rëndësishme për hetimet.

Teuta

Një Mbretëreshë për mikeshë...

Lagja 15, Rruga "Aleksandër Goga", Durrës- Shqipëri (Albania) Tel.: 052 223094 Fax: 052 22537
Info@teutadurrës.com www.teutadurrës.com

Bashkëpunimi
SHBA

Tahiri-Kaidanow: Task Forcë Rajonale kundër terrorizmit

Ministri i Brendshëm vijon takimet në SHBA

Për të luftuar terrorizmin që po kërcënon gjithnjë e më shumë me vrasje makabre jo vetëm vendet e Lindjes, është domosdoshmëri ngritja e një Tas-Force Rajonale për të pasur hetime të përbashkëta që do të shmangnin pasojat në këtë drejtim. Këtë nevojë shprehu kryetarja

e Byrosë kundër Terrorizmit në Departamentin amerikan të Shtetit Tina Kaidanow gjatë një takimi që zhvilloi me ministrin shqiptar të Punëve të Brendshme, Saimir Tahiri. Ministri tha se e vetmja rrugë për të luftuar terrorizmin është përpjekja e përbashkët rajonale. Në këtë kuadër Ambasa-

dorja Kaidanowë tha se Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të interesuar të mbështesin iniciativat të tilla. Ministri Tahiri ndodhet në SHBA në kuadër të punimeve të Samitit kundër terrorizmit. Gjatë takimit me zonjën Kaidanowë, Ministri i Punëve të Brendshme kërkoi mbështetjen e Byrosë Kundër

Terrorizmit për Drejtorinë Anti-terror të sapongritur në Policinë e Shtetit në Shqipëri. Sipas njohimit zyrtar të Ministrisë, znj.Kaidanow"-u shpreh e gatshme për të filluar menjëherë një program intensiv për mbështetjen paraprake, por edhe më gjerë për këtë njësi".



Saimir Tahiri takon në SHBA kreun e Byrosë kundër Terrorizmit

Takimi

SENAD NIKSHIQI
TIRANE



Hetimet për shpërthimin me tritol në farmacinë e babait të Ministrisë të Brendshëm Saimir Tahiri janë drejt zbardhjes. Të paktën kështu ka deklaruar kryeprokurori Adriatik Llalla, i cili nga qyteti i Shkodrës përmendi se hetimet për rastet e fundit të shpërthimit me tritol do të marrin një përgjigje në ditët në vijim. "Prokuroria Shqiptare për të gjitha ngjarjet që kanë ndodhur kohët e fundit ka filluar dhe po vijon hetimet në bashkëpunim me të gjitha strukturat e tjera shtetërore si policia e shtetit, shërbimi informativ shtetëror dhe shumë shpejt besoj se do të kemi të dhëna konkrete për ngjarjet që kanë shqetësuar apo tronditur vendin"-tha kryeprokurori. Më herët, gjatë fjalës së tij në përrurimin e godinës së re të Prokurorisë së Shkodrës, shefi i organit të hetimit tha se në Shkodër ka grupe kriminale që kanë biznese të dyshimta dhe se prokuroria e Shkodrës ka një sfidë të madhe në këtë aspekt. "Në territorin ku ushtron juridiksionin e saj prokuroria e Shkodrës ka pozicion të tillë geografik ku ndërthuren interesa të mëdha ekonomike të cilat shpeshherë krijojnë përplasje mes grupeve, klaneve ekonomike por dhe individëve që përfaqësojnë grupe kriminale, që mes tyre kanë biznese të dyshimta. Kërkohet bashkëpunim me strukturat e tjera shtetërore si dhe prokuroria e Shkodrës duhet t'i luftojë"-ka pohuar Llalla.

SITUATA E GJAKMARJES

"Prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore kanë marrë kontakte me të gjitha familjet të cilat nga viti 1990 janë përfshirë në konflikte me pasojë vdekjeje të afërmeve të tyre, ku në mjaft raste janë shqëruar me ngujim të familjeve të tyre. Rezultoni se nga shifrat e tejmbushura, ka 25 familje dhe rreth 30 persona të ngjuar. Në bashkëpunim me autoritetet e huaja kemi evidencuar rastet, me synim

prejren e rrugës fenomenit të azilkërkuesve të rremë që shpesh nisen nga ky qark"-ka shtuar Llalla. Këto deklarata u

bënë gjatë analizës vjetore të prokurorisë së Shkodrës, ku dhe u bë inagurimi i ndërtesës së re të kësaj akuzë.

Llalla: Shumë shpejt do të nxjerrim emrat e tritolvënësve

Kryeprokurori: Shkodra një rreth me probleme e grupe kriminale. Ja familjet e ngjuara

VIDEO/ LLALLA: HETIMET PER TRITOLET JANE DREJT FUNDIT


Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të AIREPORT që shkarkohet falas



AMBASADORI ANGLEZ

Ambasadori anglez Nicholas Cannon që mori pjesë në inagurimin e godinës së re të Prokurorisë së Shkodrës ishte i drejtpërdrejtë kur deklaroi hapur se është prishur harmonia fetare në Shqipëri si shkak i predikimeve nga xhihadistët për të marrë pjesë në luftën e Sirisë. "Një nga traditat më të rëndësishme të Shqipërisë është harmonia fetare, që ju duhet ta mbroini pasi kohët e fundit ajo është prishur për shkak të personave që predikojnë për të shkuar e luftuar për Xhihadin në Siri. Edhe vetë Papa e ka theksuar harmoninë fetare që ekziston në Shqipëri dhe e cila duhet mbrojtur kundër këtyre fenomeneve. Deri tani strukturat shtetërore e kanë luftuar këtë fenomen në

ZAGANJORI
"Reforma në drejtësi duhet menjëherë"



Kreu i Gjykatës së Lartë Xhezair Zaganjori nga Shkodra, përsëriti edhe njëherë se duhet bërë sa më shpejt reforma në drejtësi duke parë krimet e shëmtuara që po ndodhin në Shqipëri kohët e fundit. "Jemi në momentin kur po diskutohet nga shumë aktorë reforma në drejtësi. Duhet bërë hapa para dhe duhen ndaluar disa krimet e shëmtuara që po ndodhin në Shqipëri. Drejtësia penale duhet të operojë me shpejtësi ndërsa një dimension të ri duhet të marrë dhe këshilli i prokurorëve. Po ashtu duhet të kemi një bashkëpunim me të mirë mes institucioneve, pra një bashkëpunim me pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv"-deklaroi Zaganjori. Godina e re e Prokurorisë së Shkodrës është një ndërtesë moderne që u realizua nga buxheti i shtetit. Punimet u bënë gjatë vitit të kaluar dhe tashmë prokurorët e Shkodrës por edhe qytetarët do të kenë mundësi të operojnë në një ndërtesë me kushte bashkohore.

mënyrë efektivepor sigurisht kjo është një luftë që kërkon bashkëpunim ndërkombehtar dhe shkon përtej kufijve të një shteti"-tha ambasadori Cannon.

LAJME shkurt

Lezhë, tentohet të grabitet e moshuara

Banesa e një të moshuare në Ishull Lezhë është bërë objekt i një tentative grabitje mbrëmjen e së premtes. Sipas policisë një person i maskuar ka hyrë në banesën e shtetasës Katerina Leka 52 vjeç. Grabitësi pasi ka pikasur zonjën e shtëpisë është larguar pa marrë asgjë nga banesa, ndërsa në vendngjarje ka mbërritur policia e cila ka nisur punën për identifikimin e dhe ndalimin e autorit. Nga të dhënat e para bëhet e ditur se 52 vjeçarja jetonte vetëm pasi bashkëshortin dhe fëmijët i kishte në emigrim.



Çeravë, vidhet dyqani ushqimor në fshat

Dy persona të maskuar dhe të armatosur kanë grabitur mbrëmjen e djeshme një dyqan ushqimor. Ngjarja ka ndodhur në fshatin Çeravë të Pogradecit ku dy autorët e maskuar dhe të armatosur kanë hyrë në dyqan dhe pasi kanë qëlluar me mjete të forta pronarin kanë mundur të marrin një sasi parash. Deri më tani mbetet e paqartë shuma e grabitur nga autorët si dhe identiteti i këtyre të fundit. Policia është nisur në vendngjarje për të zbardhur rrethanat e plota të grabitjes si dhe për të identifikuar autorët.

» KEQTRAJTIMI

PEZULLOHET zv/drejtori i policisë Arben Hyseni, Robert Memelli dhe një polic tjetër. SHKB, nis hetimet ndaj tre zyrtarëve të policisë së Korçës për abuzim me detyrën.



Pamje na momentit keqtrajtimin nga policia

VIDEO/ RAHIN TE RIJUN, PEZULLOHEN POLICE

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të A1REPORT që shkarkohet falas



Pamje na momentit keqtrajtimin nga policia

Zv/drejtori i Policisë së Korçës Arben Hyseni dhe 2 efektivë policie, njëri prej tyre Robert Memelli, janë pezulluar nga detyra pas publikimit të një video, ku uniformat blu shihen duke rrahur dhe dhunuar një qytetar, në sy të zv/drejtorit. Në videon e xhiruar nga qytetarët, e gjatë 2 minuta e 17 sekonda dhe të siguruar nga televizioni "A1 Report", shihet se gjithçka nis pas një aksidenti të ndodhur në qendër të qytetit të Korçës, ku një i ri ka goditur lehtë nga mbrapa automjetin e zëvendës-drejtorit të policisë së Korçës Hyseni. Menjëherë pas kësaj, Hyseni ka telefonuar forcat e policisë për të raportuar aksidentin. Uniformat blu vijnë vetëm pak sekonda më vonë, ndërsa menjëherë i sulen të riut. Edhe pse në video nuk dëgjohej se çfarë ka biseduar i ri me uniformat blu, shihet qartë acarimi i toneve mes tyre, deri sa saktësisht në minutën 1:55 të videos shihen efektivët e policisë teksa qëllojnë dhe dhunojnë të riun. Edhe pse Hyseni është i pranishëm në automjet, ai nuk ka lëvizur për të ndaluar dhunimin ndaj të riut duke qëndruar qetësisht në mjetin e tij.

GODITJE TË VAZHUESHME
Dhunimi i të riut është i vazhdueshëm nga të dy efektivët, ndërsa as ndërhyrja e qytetarëve aty pranë nuk ka larguar dot atë nga dhuna. Menjëherë pas publikimit të kësaj video, kanë nisur hetimet ndërsa është marrë edhe vendimi i pezullimit përkohësisht të 2 efektivëve të policisë ku njëri prej tyre është Robert Memelli, dhe zëvendës-drejtorit Hyseni, të paktën deri në përfundimin e hetimeve.

DREJTORI TARKAJ
Ka qenë drejtori i Policisë së Korçës Edmond Tarkaj që në një lidhje telefonike, bëri të ditur ve ndimin e marrë nga ai për ngjarjen në fjalë. Tarkaj u shpreh se ngjarje të tilla janë të pahijshme ndërsa menjëherë ai ka marrë masat ndaj efektivëve të përfshirë në këtë ngjarje. Sipas tij debate ka nisur pas përplasjes së dy mjeteve, teksa e përfshirë në këtë aksident ishte edhe makina e zëvendës-drejtorit Hyseni. "Ajo që ka ndodhur në mes të qytetit të Korçës nga ana ime është bërë pezullimi i punonjësve të policisë që kanë marrë pjesë. Ndërkohë edhe zëvendës-drejtorit është i pezulluar nga detyra përkohësisht deri sa të bëhen hetimet nga ana e SHKB"- ka

I gërvishtti makinën zv/drejtorit policët rrahin të riun në Korçë

Keqtrajtimi filmohet nga një telefon, video shfaqet në "A1Report"

deklaruar gjatë një prononcimi në "A1Report" Edmond Tarkaj.
REAGON BERISHA
Ish-Kryeministri Sali Berisha ka reaguar në lidhje me videon e publikuar ku policët e Korçës dhunojnë një të ri pasi ky u fundit ka përplasar automjetin e zëvendës-drejtorit Arben Hyseni. "Këta nuk janë policë. Këta janë fytira e vërtetë e Ramës dhe Tahirit, janë gangsterë, çunat e krimt!! Të dashur miq, pamje tronditëse paraqiten këto kohë në

media, skena tipike të shtetit policor në të cilat policë me uniformë që përfaqësojnë shtetin guajnë në mes të rrugëve me grushta, shuplaka, shqelma si gangsterë të vërtetë qytetarë për kundravajtje. Pak ditë më parë pamë rastin e një zonje në Tiranë, dje dhe sot media raportuan rastet të tjera të keqtrajtimin të qytetarëve nga çunat e krimt, fytira e vërtetë e Ramës dhe Tahirit në qytetet e Kavajës dhe Korçës. Ky është dëshmi tjetër e shtetit policor të Edvin Kristaq

Ramës dhe neo-blokmeneve, të cilët sapo erdhën në pushtet për të hapur aksent e drogës shkrinë policinë rrugore dhe e zëvendësuan atë me trafikantë, delinkuente, si këta që rrahin njerëz në rrugë!!"- shkruan Berisha.
REAGIMI TAHIRI
Ministri i Brendshëm Saimir Tahiri ka falenderuar qytetarët për rastin e denoncuar të policisë së Korçës. Përmes një postimi në rrjetet sociale, Ministri Tahiri

është shprehur se me denoncimin e rasteve të tilla mund të luftojmë korrupsionin në Policinë e Shtetit. Tahiri thekson se autorët do të mbajnë përgjegjësi për të gjitha abuzimet e konstatuara. "Kur publiku ndihmon me denoncime, video, foto, sms, bejme bashke Policine e Shtetit më të pastër nga abuzuesit dhe të korruptuarit. Një telefon mund të kthehet në armë për të luftuar korrupsionin, abuzimin dhe shkeljet në detyrë. Ndaj punonjësit e shfaqur në filmimet e qytetarëve, do mbajnë përgjegjësi një më një për abuzimin me detyrën. Faleminderit qytetarëve që i filmuan! Faleminderit medias që i publikoi. Policinë që duam, e bëjmë bashkë." shkruan Tahiri.

RAMA: SA MË SHUMË DENONCIME TË TILLA
Kryeministri Edi Rama ka reaguar pas publikimit të videës së dhunimit të policisë së Korçës ndaj qytetarëve. Përmes një postimi në rrjetet sociale, shefi i qeverisë ka falenderuar qytetarët për denoncimin ndërsa ka theksuar se sa më shumë denoncime të tilla do të çonin në ndëshkimin e sjelljeve të patorerueshme të policisë. "Faleminderit qytetarit që me videon e celularit çoi në ndëshkimin e sjelljes së patorerueshme të patrullës së policisë! Sa më shumë të tilla!!"-shkruan Rama.

ARRESTOHET EMILJANO PELUSHI

Personi që aksidentoi Pekën i dehur, me 50 km/h mbi normën

Policia e Tiranës arrestoi Emiljano Pelushin si shkaktar të aksidentit të mbrëmjes së të enjtes ku humbi jetën Fleura Kola dhe u plagos gazetari Çlirim Peka. Sipas hetimeve paraprake, Pelushi drejtonte makinën në gjendje të dehur dhe ecte me 80 km/h kur tabela kufizonte në 30 km/h. Burime nga policia rrugore thanë për "A1Report" thanë se Pelushi rezultoi pozitiv me 0.7% në testin e alkoolit. Në hyrje të autostradës Tiranë-Elbasan pranë Mulletit ku ndodhi aksidenti që i mori jetën Fleura Kolës, shpejtësia



Pamjen nga aksidenti i Cim Pekës

maksimale me të cilën duhet të udhëtojnë automjetet është 30 kilometër në orë. Por drejtuesi i "Audit" që përplasi makinën Benz CLS të gazetarit Çim Peka ku udhëtonte dhe vajza e ish-ambasadorit në Romë, Llesh Kola, e ka anashkalluar totalisht tabelën që përcaktonte kufirin e shpejtësisë, duke ecur me 80 kilometër në orë. Mbi këto rezultate paraprake, policia e Tiranës arrestoi mëngjesin e kësaj të premtjeje Emiljano Pelushin si shkaktar të aksidentit që ndodhi rreth orës 19:30 në afërsi të Mulletit ku humbi jetën 29-vjecarja Fleura Kola

dhe u plagos gazetari Peka. Por jo vetëm kaq, Pelushi ka qenë duke drejtuar automjetin në gjendje të dehur. Burime nga policia thanë se Pelushi rezultoi me 0.7% në testin e alkoolit. Gazetari Çlirim Peka dhe Fleura Kola, punonjëse në Ministrinë e Drejtësisë ktheheshin nga Elbasani drejt Tiranës. Makina e gazetarit Peka me targa AA 099 GB u kthye përmbys si pasojë e përplasjes. Automjeti i dytë i përfshirë në aksident Audi me targa AA 566 HT drejtohej nga Emiljano Pelushi, i cili ka mbetur i plagosur.

Integriteti dhe korrupsioni

NGA **FATOS ÇOÇOLI**

vijon nga faqja 1

Madje ngajné disi idealiste, në mjedisin tonë ku qytetarët ende i besojnë pak përdorimit të kompjuterit dhe internetit për të zgjidhur hallet e tyre. Dhe akoma më pak atyre që qëndrojnë pas "kutive" virtuale të portarit, ku shkruhet "polici", "shëndetësi", "arsim publik", "dogana", "tatime", etj. Të presësh që qytetari të të ndihmojë për ta zhbuar korrupsionin është deri diku një qëndrim pasiv. Qeveria jonë duhet të kuptojë se sado portale kundër korrupsionit të krijosh, je në periferi të luftës së vërtetë për ta kufizuar atë. Korrupsioni është si një kuçedër, që sado koka të presësh duke marrë informacion nga denoncime, gjithnjë dalin të tjera edhe më të shumta. Korrupsioni kufizohet dhe mbahet nën kontroll vetëm me luftën në sistemin dhe me goditjen nga rrënjët, aty ku ai lind. Lufta parandaluese është arma më e aftë për të goditur korrupsionin, për t'i rrembyer të ardhmen atij! Korrupsioni e ndërton të ardhmen e vet me shumë kujdes dhe durim. Studjon aleatët e tij të natyrshëm, korrupton njerëz që për parane abuzive mund të bëjnë shumë gjera, frikëson ata që nuk korruptohen, me mesazhin "shih punën tënde e mos llap, se ndryshe do të përfundosh keq". Të korruptuarit e gjejnë lehtë njeri-tjetrin, lidhen fort me sho-shoqin, kanë një komunikim për t'u admiruar dhe aleancat-klane të tyre janë tejet të qëndrueshme e punëmbaarur. Të ndodhur përpara murit korrupsion, qeveri të vendete të ndryshme hartojnë strategji dhe programe të veçanta për luftën kundër tij. Vihet re, jo vetëm në rastin e Shqipërisë, se shumë qeveri tentojnë të anashkalojnë forcën dhe incizivitetin e punës së organeve të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm shtetëror të financave publike, në garën për të rrembyer sa më shumë pikë publike në strategji e qasje kundër korrupsionit. Qeveria e sotme është mirë të mos i dorëzohet kësaj ngasjeje. Korrupsioni goditet në zemër të tij, vetëm në rastet kur luftohet gjeneza nga lind, kushet që e bëjnë të lulëzojë. Pa goditjen në parandalim, pa rritjen maksimale të llogaridhënies dhe transparencës, dy visaret kryesore të integritetit të një institucioni shtetëror, duhet ta harrojme se do të mund të hyjmë në rrënjët e korrupsionit dhe ta mposhtim atë. Megjithë përpjekjet e qeverise se sotme për të denoncuar veprimet korruptive, ndjeshmëria e shqiptarëve se shteti ynë është i krimbur në korrupsion, paperegjegjshmeri e abuzive do

të vijojë, përdërisa korrupsioni nuk do të luftohet nga rrënjët. Dhe rrënjët duhen gjetur në të gjitha institucionet publike, të cilat duhet të fillojnë katarsisën e vërtetë, pastrimin, nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit dhe grilës së integritetit. Kontrolli i integritetit te çdo institucioni publik është një sfidë e veçantë, por thelbësore. Prej këtej nis lufta më efiçente dhe e plotë kundër korrupsionit, pse e godet atë në gjenezën, në fillesat e tij. Një program shumë i mirë vetëvlerësimi të integritetit (i quajtur Into-Saint) është zhvilluar nga Gjykata Hollandeze e Auditimit në vitin 2012. Ndonëse ky program ju adresua fillimisht institucioneve të auditimit suprem (ndërmjet të cilave është dhe KLSH-ja jonë), ai vien për çdo institucion shtetëror. Kontrolli i Lartë i Shtetit u njoh me programin Into-Saint në vitin 2012 dhe vendosi zbatimin e tij. Periudha deri në fund të vitit 2013 ishte periudhë e njohjes më të thelluar të Programit dhe e verave të tij. Gjatë vitit 2014 dhe këtë vit, KLSH po provon vetëvlerësimin e integritetit të vet, me ndihmën e organizatave të shoqërisë civile. Kjo qasje duhet marrë nga qeveria jonë qëndrore, por dhe nga pushteti vendor, shpresojmë ai disi më idealist që do të dalë nga zgjedhjet e qershorit 2015. Me një vendim të veçantë, qeveria e ka në dorë të mundësuar që institucionet më të rëndësishme të Shtetit, nga ministritë deri te drejtorit qëndrore, bashki dhe ndërmarrje publike në formën e shoqërive aksionere, ku luhen me dhjetëra miliona euro para të taksapaguesve shqiptarë dhe ku, nga shkeljet e abuzimit, edhe dëmi ekonomik është po ashtu në



nivele miliona euro, të njihen dhe në mënyrë të detyruar ta zbatojnë instrumentin e vetëvlerësimit, procesin dhe programin Into-Saint. Ka dhe "ushtarët" për të mbikqyrur dhe drejtuar procesin. Janë me qindra audituesit e brendshëm, të cilët duhen mësuar dhe trajnuar për të zbatuar Into-Saint në institucionet e tyre. Në luftën kundër korrupsionit janë të përfshira në front të parë institucione të posaçme, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Prokuroria, Departamenti i Parandalimit të Krimit Ekonomik, Departamenti i Parandalimit të Pasurimit të Parave, Policia e Shtetit etj.

Të gjitha këto institucione duhet ta njohin dhe përvetësojnë teknikën e programit Into-Saint. Asnjë institucion shtetëror nuk është në gjendje të luftojë me efiçencë korrupsionin, në rast se me një proces transparent dhe korrekt vetëvlerësimi, nuk del me integritet të lartë për vete. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka dalë nga statusi i strukturës gjobëvënëse të disa viteve më parë dhe po përpiqet t'i kthejë në nivelin e duhur të përgjegjshmërisë dhe integritetit institucionet publike që ai kontrollon (praktikisht të gjithë ngrehinën e Shtetit dhe qeverisë). Mirëpo i vetëm ai nuk mund të arrijë rezultatet që presim të gjithë

si qytetarë nga lufta e ndershme kundër korrupsionit, jo nga ajo "luftë" e llaveve të bukura, seminareve, konferencave me banera dhe mesazhe prekeë apo të forta. Nëse shoqëria civile dhe opinioni publik, pse jo dhe mediat, bashkohen me KLSH dhe risin kërkesën e llogarisë dhe presionin pozitiv, edhe Kuvendi e qeveria do të mund të kenë ndër duar instrumentin më efiçent kundër korrupsionit, vetëvlerësimin e integritetit, parandalimin, krijimin e ambientit antibiotik ndaj farës së abuzimit dhe përvetësimit, procesin që e rikthen të plotë integritetin në moralin dhe mjedisin tonë publik.



BLOG PERIFERI

Vajzat pa emër

NGA **ALBA MALLTEZI**

vijon nga faqja 1

...për të dhënë të vërtetën... Por gazetarët, në tregimin e këtyre ngjarjeve, siç ishte dhe mbremë rasti i 29 vjeçares Fleura Kola, përplasen nga një burim të tjetri, gënjejehen, manipulohen, depistohen.



Fleura Kola

Dhe veçanërisht në këto raste, pengohen t'i afrohen vendngjarjes me të gjithë forcat dhe nga të gjithë: punonjës të rendit, mjekë, politikanë, kolegë të "mashkullit" që ishte në timon me vajzën "e gabuar" dhe jo me bashkëshorten.

Në radhë të parë do të doja të shkatëroja me përbuzje paragjykimin dhe mendimin automatik se vajza në krah të një gazetari, të një politikani, të një biznesmeni është automatikisht "dashnorja".

Përbuz mentalitetin e një shoqërie të pa evoluar që kategorizon një vajzë, një grua të dashuruar apo jo, si një figurë që gaboi sepse ishte në vendin e gabuar dhe me njeriun që nuk duhet të ishte, pasi ai njeri duhet të ishte në krah të bashkëshortes. Dhe për këtë, shoqëria, në një solidaritet të paparë, fsheh apo tenton të fshehë emra, ngjarje.

Në rastin e Fleurës, të cilën për herë të parë e të fundit e pashë


në fotot me buzëqeshjen dhe kaqurrelat e verdhë të zgjedhura prej saj në kronikat personale të Facebook-ut, dëshiroj të jetë larguar nga kjo botë si një vajzë e lumtur. Si një vajzë që ishte vetvetja dhe nuk harxhonte asnjë sekondë të jetës së saj me njerëz që nuk ja vlen, që nuk i donite.

Nëse Fleura ishte vajzë e dashuruar, me siguri, ishte dhe vajzë plot guxim dhe shpërfillëse e paragjykimëve të mykura maskiliste.

Në të vërtetë, vetëm dashuria të jep krahët e forcën të jesh vetvetja më këdo e kurdoherë.

Nuk e di se si do të ishin sjellë në raste të tjera emra të njohur të shoqërisë shqiptare të përfshirë në të tjera aksidente tragjike. Ata kanë vdekur. Por në rastin e gazetarit Cim Peka, duke i uruar shërim të shpejtë, do të doja që ai i pari, e të tjerë më pas, të flisnin me respektin e duhur për Fleurën si vajzë, si shoqe, si mike.

» PËRKTHIMET



Enes Karić

SHKRIMTARI i shquar boshnjak rrëfen në një sfond politik e kulturor intrigat, komplotet, konfliktet fetare dhe etnike mes përplasjes së qytetërimeve perëndimore dhe lindore



“Këngët e zogjve të egër” i Karić vjen në gjuhën shqipe

Romani provokon me ngjarjet tronditëse të Sarajevës dhe Bosnjes së fundit të shekullit të XVI

DHURATA HAMZAI
TIRANE

Romani “Këngët e zogjve të egër”, i shkrimtarit boshnjak Enes Karić, i baravlershëm me majat e letërsisë europiane, vjen edhe në shqip. Vepra është përkthyer nga origjinali boshnjakisht prej Ben Andonit i botuar nga “Botimet Poeteka”. Shkrimtari bashkëkohor boshnjak, Enes Karić, është një nga emrat më të njohur në hapësirën letrare të Ballkanit. Më në fund ai i shtohet gjerdanit të botimeve në Shqipëri me prozë bashkëkohore nga Ballkani. Në këtë gjerdan renditen emrat më të rëndë-

sishëm letrarë si Tomaz Šalamun, Alek Popov, Renato Baretic, Georgi Gospodinov, Edo Popovic, Nikola Madzrov, Vladimir Arsenijevic, Ognjen Spahic, Titos Patrikios, Jevrem Brkovic, etj. Romani i vendos ngjarjet në Sarajevën dhe Bosnjën e fundit të shekullit të XVI. Në Europë, Rilindja dhe idetë e saj kanë ndriçuar, por edhe kanë tronditur jetën e banorëve dhe të institucioneve të kontinentit. Perandoria osmane, që ndërkaq ka mbërritur si zgjatim thuajse deri në zemër të Ballkanit, provoi humbjen e parë nga ushtritë e bashkuara të forcave europiane. Ka gjashtë gjëra në jetë: Lufta dhe vdekja, dashuria dhe loja, puna dhe besimi. Lufta dhe vdekja janë këtu, të pafuara dhe së

bashku, ashtu si i sëmurë me sëmundjen, ashtu si i vdekur dhe varri, ashtu si lebrozi dhe lebra. Me dashurinë dhe lojën harrojmë luftën dhe vdekjen. Me dashurinë zgjohet entuziazmi, porse me lojë shpërqendrimi, e të dyja zgjasin fare pak, krejt sa ndërrimi i ditës me natën. Lavdo jetën, pasi është më e bukur nga vdekja! Lavdo vdekjen, pasi është më e ëmbël se Ferri. Le t'ua japim dashurinë pra, atyre që e kanë më të nevojshme. Kjo panoramë, me sfond politik, kulturor, me pranim dhe përplasje mes dy qytetërimeve, që përplas fort mes tyre edhe njerëzit, e ku linja dashurie vetëdijë, rrefehet përmes një fëmije që rritet dhe zhëngon se si përballë syve tuj gjithëkrah ndryshon me vull. Pasi ka studiuar


dhjetë vjet në medresetë e Stambollit dhe pesë të tjera në Firence, duke mësuar shkencën e astronomisë, ai kthehet në Sarajevë. Çfarë identiteti ka ky njeri i ushqyer prej dy burimeve të dijes? A ndihet i huaj, i tëjuajësuar përballë njërës prej kulturave? Si e perceptojnë atë pas kthimit nga Perëndimi njerëzit e tij? Ku fshihet dhe ky rri esencialisht dallimi mes dy dashurive: dashurisë për njeriun dhe dashurisë së pafundme për Zotin? A do të mundet ky njeri të hidhte tulla dhe gurë ndaj kundërshtarëve? A do të jetë më i aftë ky njeri të bjerë sërish në dashuri me kulturën, vendlindjen, njerëzit e tij? Mos i lër hamzevët të prishin rininë, mos lër kizilbashët të lartësojnë shumë vdekjen e njerëzve të nderuar, mos i lejo hubimeshitët të ndajnë kufirin mes fesë tonë dhe asaj të të krishterëve, qëndro kundër berligitëve, pasi ata po i hutojnë njerëzit me lloj-lloj broçkullash për fenë e vërtetë.... Këta zëra, këtë urdhër dëgjon personazhi që vë në lëvizje këtë histori ku gjithëka: idetë e reja, simbolet e Botës së Re, zbulimet, besimi, dashuritë, krijimtaria artistike, jeta e përditshme dhe e ardhmja, rrjedh nën këtë hark të jashtëzakonshëm kohor dhe ecën mbi dhe përmes urave, që ngritën këto qytete-simbole.

DY FJALË PËR SHKRIMTARIN

Enes Karić është një nga emrat më të njohur të Ballkanit, dijetar i diplomuar në Universitetin e Sarajevës për Shkencat Politike dhe në disiplinën e Studimit të Islamit. Specializimet e tij janë kryer në Beograd, në universitetet e Al-Azhar (Egjypt), Kajros, Yale (SHBA) dhe Oksfordit (Britania e Madhe). Është bashkëpunëtor pranë UNESCO-s dhe dekan i Fakultetit të Studimeve të Islamit në Sarajevë. Enes Karić ka qenë profesor i jashtëm në Universitetin e Ljubllanës dhe në Universitetin “Ludëig Maximilian”. Kryeministri Haris Silajdžić e kishte në kabinetin e tij (1994-1996), ku Enes Karić kontribuoi si ministër i Arsimit, Shkencës, Kulturës dhe Sportit. Përveç romanit “Këngët e zogjve të egër” Karić ka botuar me sukses veprat “Tulipani i zi” (përshkrime udhëtimi-2008) “Varreza hebreje”-roman, etj.

GKA-EKSPOZITA

Mircan “provokon” me realizmin socialist



— Punëtorët dalin nga studioja, duke mos parë më realizëm socialist”, është quajtur edhe ekspozita e cila do të çelët në datën 27 shkurt 2015, ora 18.00, në ambientet e Galerisë Kombëtare të Arteve. GKA-ja në bashkëpunim me Zyren e Projekteve për Artet dhe Shkencat Humane “Departamentin e Shqiponjave” dhe me mbështetjen e Fondacionit “Prins Claus”, Hollandë, do të hapin për publikun në sallën e ekspozitave të përkohshme ekspozitën ndërkombëtare, e cila do të vijë e kuruar nga Mihnea Mircan. GKA njofton se ekspozita do të sjellë vepra nga artiste si Irëin (Slloveni), Armando Lulaj (Shqipëri), Ciprian Mureşan (Rumani), Santiago Sierra (Spanjë), Jonas Staal (Hollandë) dhe Sarah Vanaag (Belgjikë), gjithashtu edhe një përzgjedhje ekskluzive veprash nga fondi i GKA-së. Kuratori Mihnea Mircan është shprehur se “Ekspozita ngrihet mbi dy hipoteza për realizmin e epokës socialiste, mbi dy mënyrat sesi diskursi i asaj periudhe nuk mori fund”. Ekspozita sjelle mesazhe për marrëdhëniet mes lirisë artistike dhe shërbimit politik, shtylla ku mbështetet prandimi i artit realist socialist

KUMBARO-SHALA-MURATI, MARRËVESHJE PËR 2015-N

Kosova dhe Shqipëria premtojnë ngritjen e qendrave kulturore në Diasporë

Sot nënshkruam kalendarin, por kalendari 2015 ka filluar. Besa Llugiqi e Prishtinës, shkëlqeu në skenën e Tiranës një javë më parë, krahas artistëve me standarde botërore siç është Gëzim Myshketa apo Ermonela Jaho në skenën e Teatrit, Operës dhe Baletit në Tiranë. Para pak ditësh, veprat e Muslim Mullaqit ndërruan strehë nga Tirana në Prishtinë, duke mbetur edhe të Tiranës dhe të Prishtinës. Dje trupa e Qendrës Kombëtare të Fëmijëve dha shfaqjen në Prizren dhe nuk priten asnjëri nga këta artist nënshkrimin, por vetëm në nxitën ne që të ecim sa më shpejt me mbështetjen e institucioneve”, tha ministraj e kulturës Mirela Kumbaro dje gjatë

nënshkrimin të Kalendarit të Përbashkët Kulturor shqipëri Kosovë për vitin 2015 me homologun e Kosovës, Kujtim Shala. “Do të jetë një kalndar më më i pasur me programe të përbashkëta kulturore ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë” u tha dje në konferencën për median. Është viti i dytë që Kosova e Shqipëria e nënshkruajnë Kalendarin e Përbashkët Kulturor. Për këtë vit, sipas të dyja ministrave agenda është e pasur dhe do të jetë publike për të gjithë, ku të gjithë të interesuarit do të kenë mundësi ta shohin atë në uebfaqet zyrtare të këtyre ministrave. Në takimet e ditësh së djeshme ministrja Kumbaro pati edhe një takim me Ministrin e Diasporës së Kosovës, Valon



Murati, ku kanë folur për objektivat dhe detyrat që dalin nga Ligji i Diasporës dhe aktivitet kulturore për diasporën. Ministri Murati e njoftoi ministrin Kumbaro për funksionimin e tri qendrave kulturore në diasporë, konkretisht në Turqi, Zvicër dhe Suedi. “Prej këtu rrodhi edhe ideja që të themelohen qendra të përbashkëta kulturore në diasporë, të cilat do të shërbenin si vende ku mësohet për gjuhën dhe kulturën shqiptare, që atë ta paraqesin sa më mirë para botës”, thuhet në njoftimin e Ministrisë së Diasporës. Kumbaro theksoi krijimin e një modeli të qendrave kulturore që do të kishte sukses për shumë vjet. Palët ranë dakord që të kontribuojnë me projekte të përbashkëta.

» » EKSKLUZIVE



Milan SHUFLAJ

Fakte të panjohura rreth dorëshkrimeve për shqiptarët

Me rastin e përvjetorit të vdekjes së albanologut të madh kroat, një analizë mbi jetën dhe veprën kushtuar albanologjisë dhe historisë së Shqipërisë...

DR. MUSA AHMETI
TIRANE

Paanshmëria, korrektësia dhe simpatia e madhe ndaj popullit shqiptar, lidhjet e afërta me Shqipërinë, pranimi dhe argumentimi në mënyrë shkencore i tezës së prejardhjes së drejtpërdrejtë të shqiptarëve nga ilirët, si dhe autoktonia e tyre në trojet shqiptare, ishin shkaqe që e shtynë Beogradin për të organizuar vrasjen e Milan Shuflajt më 18 shkurt të vitit 1931. Menjëherë pas atentatit, policia konfiskoi të gjitha dorëshkrimet që ndodheshin në apartamentin e tij. Një pjesë e mirë nga këto dorëshkrime mesa duket kanë humbur përgjithmonë, sepse edhe sot e kësaj dite nuk u gjenden ndonjë gjurmë. Jehona e vrasjes ishte e madhe. Reaguan me shkrimet e tyre "Tribuna" (Romë), "Berliner Tagblatt", "Neë York Times", "Frankfurter Zeitung", "Arbënia", "Vullneti i Popullit" (Tiranë), etj. Me një memorandum të veçantë reaganu edhe kolosët e shkencës e të lettrave si Albert Einstein, Heinrich Mann, dr. Josef Bajza, dr. Max Hildebert Boehm, dr. Karl Fritzer, dr. Zenon Kuziela, dr. Martin Spahn, dr. Branimir Jeliç, Josip Milkoviç, Lumo Skendo, Faik Konica, si dhe organizatat "Ligue Internationale des Droits de L'Homme", "Federation Universitaire Internationale", etj.

Interesimin e Shuflajt për shqiptarët dhe Shqipërinë e


ndeshim që në fillim të karrierës së tij shkencore, kur, duke hulumtuar e mbledhur dokumenta nëpër arkivat e Dalmacisë, për "Codex diplomaticus" të Tadija Smičklastit, zbulon materiale burimore shumë interesante, të pabotuara, që i takonin mesjetës shqiptare. Kjo periudhë, në atë kohë ishte e pahalumtuar fare dhe zgjon interes të jashtëzakonshëm tek studiuesi i ri, interesim i ri që e preokupon që shumë, sa bëhet qëllim kryesor i veprimtarisë shkencore për gjithë jetën e tij. Gjatë gjithë kësaj periudhe kohore, nga pena e dr. Milan Shuflajt dolën studime të jashtëzakonshme me vlera të larta shkencore në fushën e albanologjisë. E tillë është vepra monumentale "Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia", të cilën e botoi së bashku me Ludvig Thallocon dhe Konstantin Jirečekun. Materialin e mbledhur, dr. Shuflaj e sistemoi dhe e përcillte me komente të ndryshme, kësh-tuqë në të shumtën këto komente, paraqesin diskutime me vlerë të lartë shkencore dhe mund të shfrytëzohen si studime të veçanta. Punojë për përgatitjen e botimit të kësaj kryevepre e ka vazhduar edhe më tutje.

Në Arkivin Qendror Shtetëror të Tiranës, ruhen regestat për vëllimin e tretë të "Acta Albaniae..."

Në shtypin periodik si dhe studime të veçanta në Kroaci, Shqipëri, Kosovë, Greqi, Austri, Itali, Hungari por, edhe gjetiu, është shkruar se është gjetur vëllimi i tretë i cili ishte i gatshëm për botim. Në fakt, e vërteta është krejtësisht e kundërt.

Dr. Milan Shuflaj nuk kishte arritur ta përgatiste për

botim vëllimin e tretë, ashtu siç është shkruar e pohuar deri tani. Në dorëshkrimet e tij, të cilat ruhen në Arkivin Shtetëror Kroat në Zagreb, një pjesë e këtyre dokumenteve, janë të shpërndara nëpër kuti të ndryshme. Kjo është e tëra që është zbuluar pas hulumtimeve të bëra, e jo dorëshkrimi komplet i vëllimit të tretë, siç pohohet tani. Pra dr. Milan Shuflaj nuk e kishte shkruar e as që e kishte përgatitur për botim vëllimin e tretë. Pohimet e mësipërme, u vërtetuan, kur në Arkivin Qendror Shtetëror të Tiranës, në fondin e Ministrisë së Arsimit, [fondi 295, dosja 85, f. 1-43, viti 1931], nga ana e dr. Musa Ahmetit u zbulua përmbytja e vëllimit të tretë të "Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia", që shumë të përfolur, i cili shkaktoi edhe debete e polemika të shumta te studiuesit, historianët, por edhe te gazetarët. Duke studiuar dorëshkrimet e Sufflay-t, por edhe burimet tjera arkivore mund të themi se se "disa prej veprave më të rëndësishme të këtij studiuesi, që janë konsideruar të botuara, në fakt kanë qenë vetëm pjesërisht të botuara." Këtu mund të përmenden: "Biologjia e fisit shqiptar" (1915), "Historia e Shqipërisë së Veriut" (1924), "Kadastri i Shkodrës" (1926), "Historia e Shqipërisë - prospekt" (1930), në anën tjetër, disa studime monografike të vëllimëshme, pothuajse të përfunduara, edhe sot kësaj dite nuk janë botuar, përkatësisht ato janë "te papërmendura dhe të pacituara në burime dhe literaturë të albanologëve dhe historianëve shqiptarë dhe të huaj si p.sh. "Statuti, ipeshkvia dhe qyteti i Durrësit," "Biografia e Pal Engjëllit dhe e Pal Dushmanit të Krajës," "Statuti i Drishtit," "Familjet fisnike shqiptare në mesjetë," "Qytete të tjera mesjetare shqiptare - Shkodra, Tivari, Shasi, Bajeza (Balezio), Danja, Medua, Ulqini etj.," "Fiset, vëllazëritë, emrat dhe mbiemrat tek shqiptarët në mesjetë," "Mbi emigrimin e shqiptarëve." "Familja dhe fshati shqiptar në mesjetë." "Armët dhe ushtarët shqiptarë në mesjetë." "Harta gjeografike të Shqipërisë dhe të Ballkanit Jugor," "Shin Sergji e Baku në Bunë" "Shin Gjoni Vladimiri", etj. Shuflaj, kishte përgatitur, ashtu si edhe në dy vëllimet e mëparshme, tashmë të botuara, "regestat" [sinopsis] e dokumenteve që duhej të futeshin në vëllimin e tretë. Informacionet për ekzistencën e këtyre dokumenteve M. Sufllaj i kishte nxjerrë nga botimet e ndryshme të korpuseve burimore me autorë Baronius, Cerone, Eubel, Farlati, Fernandez, Gellichi, Hopf, Iorga, Ljubici, Makusev, Marinenco, Pastor, Thalloczy, Theiner, Eaddingo, që kishte arritur t'i konsultonte gjatë përgatitjes së dy vëllimeve të para të Acta Albaniae. Nga këto botime ai kishte mbledhur jo vetëm të dhënat për përmbytjen e



Kush ishte Milan von Sufflay?

— Millan Shuffaj ka lindur në vitin 1879, në Lepoglavë të Kroacisë. Shkollën fillore e mbaron në vendlindje, ndërsa Gjinnazin Klasik në Zagreb, ku laureohet si nxënësi më i mirë i gjenarës së tij. Studion shkencat shoqërore në Universitetin e Zagrebit. Doktoron në vitin 1901. Menjëherë pas doktoratës, Shuffaj i futet punës për sistematizimin, mbledhjen dhe përshkrimin e dokumentave mesjetare nga arkivet e qyteteve bregdetare dalmatinase për "Codex Diplomaticus". Këtu ishin kontaktet e para të studiuarit të ri me lëndën e vëllimshme dhe të pahulumtuar fare, që i takonte Shqipërisë. Në vitin 1902, Shuffaj mbron me sukses provimin për profesor në shkencat ndihmëse të historisë, në Universitetin e Zagrebit. Në vitet 1902/3 specializohet në Vjenë, në Österreichische Institut für Geschichtsforschung, në fushat e paleografisë latine, diplomacisë, kronologjisë dhe notariatit, tek profesorët: O. Redlicha dhe A. Dopscha. Në këtë vit, regjistron tek prof. K. Jireček, "Studimet albanologjike në Kolegjin e Vjenës", të cilat nuk ka arritur t'i përfundojë. Në vitet 1904-1908, dr. Shuffaj punon si asistent në bibliotekën kombëtare Szecezy, të Budapestit. Këtu thel-

Njohuritë

Shuffaj punon si asistent në bibliotekën kombëtare Szecezy, të Budapestit. Këtu thellon njohuritë në fushën e ballkanologjisë dhe sidomos albanologjisë. Vendos kontakte të shumta me intelektualë dhe shkencëtarë me famë botërore



Portret i Milan Shuffaj nga viti 1931

dokumentave, por edhe për vendndodhjen e tyre. Shënimet mbi dokumentat i grupon sipas arkivave dhe bibliotekave ku ato ndodheshin si në Arkivin e Venedikut (450 dokumente nga vitet 1407-1451), Arkivin e Vatikanit (113 dokumente nga vitet 1405-1451), Arkivin e Napolit (20 dokumente, nga vitet 1402-1451), Arkivin e Barcelonës (12 dokumente nga vitet 1447-1451), Arkivin e Ankonës (8 nga vitet 1412-1439), Museo Civico të Venedikut (2 nga vitet 1420), etj. Është interesant fakti, që në përmbajtjen e vëllimit të tretë, M. Sufflay nuk kishte futur dokumentat nga Arkivi i Barcelonës të cilat i kishin përshkruar për llogari të tij disa scribes spanjollë, dhe që ky ia kishte huazuar akademikut serb në Beograd, Jovan Radoniq, për konsultim për një studim. Ky i fundit i botoi ato në vitin 1942, pas vdekjes së M. Sufflay. M. Sufflay i kishte kërkuar me këmbëngulje që Radoniq t'ia kthente dokumentat nga arkivi i Barcelonës, e megjithatë ai i kishte mbajtur ato, edhe pse i kishte premtuar Sufflay-t se do t'ia kthente.

ZBULIMET MË TË REJA NGA ARKIVI SHTETËROR I DUBROVNIKUT

Shuffaj, kishte lënë pa përfshirë këtu edhe disa dokumente nga Arkivat e Dubrovnikut dhe Kotorit. Një gjë të tillë, e ka pouluar vetë, në një letër të zbuluar kohë më parë në Arkivin e Dubrovnikut. Në letër, e cila mban datën e 9 janarit të vitit 1931, ai kërkon t'i mundësohet studimi i dokumentave që ruhen në këtë arkiv, sepse po përgatitej të botonte vëllimin e tretë të: "Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia". Me këtë rast, nga vetë dora e Shuffajit, kemi një të dhënë shumë të rëndësishme, se vëllimi i tretë po përgatitej, dhe se nuk ishte shkruar akoma. Përveç kësaj letre, në Arkivin e Dubrovnikut, është zbuluar edhe procesverbal i bërë nga arkivi për studimet që bëri Milan Shuffaj atje, deri me 17 shkurt, d.m.th. një ditë para se të vritej. Ky procesverbal, është i një rëndësie të dorës së parë, sepse atë janë shënuar me saktësi dhe pedantëri të gjitha vëllimet, dokumentat dhe dorëshkrimet që ka shfrytëzuar Shuffaj gjatë kërkimeve shkencore në këtë arkiv. Kjo, është një lehtësi e jashtëzakonshme për të bërë rikonstruimin e gjithë asaj që Shuffaj studioi dhe përshkroi për vëllimin e tretë të kryeveprës së tij "Acta Albaniae..." Gjatë punës kërkimore, M. Shuffaj kishte studiuar dokumentat deri në përfundim të vitit 1451, vit ky që llogaritej edhe si kufiri i fundit për vëllimin e tretë të veprës së tij.

vijon nesër...

lon njohuritë në fushën e ballkanologjisë dhe sidomos albanologjisë. Vendos kontakte të shumta me intelektualë dhe shkencëtarë me famë botërore, kontakte këto që do t'i shfrytëzojë më vonë, gjatë gjithë punës së tij shkencore. Në Budapest, Shuffaj botoi në revista dhe gazeta të ndryshme, një numër të madh punimesh shkencore me vlera të jashtëzakonshme. Në revistën Szazdok, boton dy punime për mesjetëtarë kroatë, ku me argumente shkencore tregon se dokumentet e Rabit të shek. XI dhe XII, për mbretin kroat Zvonimir, ishin falsifikat. Kjo gjë më vonë do t'i kushtojë shumë, sepse do të shpallet tradhtar i popullit kroat, dhe studentët e tij do t'ia bojkotojnë leksionet! Në vitin 1908, emërohet profesor i rregullt për shkencat ndihmëse të historisë në Universitetin e Zagrebit. Së bashku me Talocin dhe Jirečekun, në vitin 1913 dhe 1918, boton në dy vëllime kryeveprën "Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia". Në vitin 1918, me kërkesën e tij pensionohet, e pastaj boton pjesën e tretë të Historisë së Shqipërisë, të cilën kishte planifikuar ta shkruante në tetë vëllime, me titull: "Die kirchensächliche eändred des Mittelalters, dhe "Povjest sjevernih Arbanasa". Pë të botuar pastaj në vitin 1925 studimin: "Srbi i Arbanasi, njohova simbioza u srednjem vijeku". Në vitin 1928 botoi librin me ese: "Hrvatska u svjetlu svjetske historije i politike". Po këtë vit, emërohet profesor i rregullt në Universitetin e Budapestit. Për shkak se nuk kishte pasaportë, detyrohet ta refuzojë këtë emërim. Problemet me policinë, janë pjesë përbërëse e jetës së dr. Shuffajit. Sipas disa të dhënave më të reja, të zbuluara në Arkivin Shtetëror Kroat në Zagreb, dr. Milan Shuffaj është njëri ndër shkencëtarët e rrallë në botë, që është vëzhguar në çdo hap nga policia, e jo vetëm ai, por edhe personat me të cilët kontaktonte, duke përfshirë këtu edhe anëtarët e familjes së tij të ngushtë dhe të gjërë. Një mbikqyrje e tillë ka filluar në fund të vitit 1922, gjë që mund të dëshmohej nga dokumentet arkivore. Fillimisht është vëzhguar vetëm ditën, ndërsa më vonë 24 orë pa ndërprerje. Në vitin 1929, Akademia Vjeneze e Shkencave i propozon dr. Shuffajit që të vazhonte vëllimin e lëndës arkivore për vazhdimin e botimit të "Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia", vëllimet III-V. Këtë iniciativë e përkrahu edhe qeveria e Mbretërisë Shqiptare, e cila shprehu gatishmërinë e saj që të hiqte shpenzimet për një ndërmarrje të tillë kaq serioze dhe të vlefshme. Dr. Milan Shuffaj rrohet të vizitojë Shqipërinë. Pas shumë peripecish rreth pajisjes me pasaportë, ai arrin në Shqipëri më 12 janar të vitit 1931. Vritet nga dora e kriminelëve serbë më 18 shkurt të vitit 1931, një ditë pas kthimit nga Shqipëria, duke lënë pas shumë studime të papërfunduara, në dorëshkrim, një pjesë e mirë e të cilave ruhet në Arkivin Shtetëror të Kroacisë në Zagreb.

Vëzhgimi

Milan Shuffaj është njëri ndër shkencëtarët e rrallë në botë, që është vëzhguar në çdo hap nga policia, e jo vetëm ai, por edhe personat me të cilët kontaktonte, duke përfshirë këtu edhe anëtarët e familjes së tij



NGA ARBEN DUKA

SATIRË POLITIKE

Një administrator për Bashkinë e Tiranës dhe për bashkitë e tjera..

Duket ka një ankh, për zgjedhjet e reja, po ende s'ka nisur, me tamam beteja.

Ende pa filluar, nuk mund t'i bëj prita, nëse një të zotin, e nxjerr opozita!

Ende s'janë vënë, në prizë bateritë, që të karikohen, fiks për atë ditë.

Në zgjedhjet vendore, kur del një i ri, nuk mund të votohet, me tifozeri!

Janë zgjedhje vendore, sigurisht që vlejné, po në politike, ne gjithnjë i kthejmë!

Emra konkurrentësh, vijné dhe tek mua, po unë jam skeptik, të votoj një grua!..

Po kanë goxha vlerë, zgjedhjet që do vinë, provë për opozitën, test për qeverinë.

Gratë me shumicë, janë promovuar, por asnjë për be, nga ato s'është shquar!

Sot që unë po shkruaj, nuk është as fillim, dhe nuk mund të bëj, një parashikim!

Megë është fillimi, nuk do bëj komente, po shumicë e grave, janë inekzistente!..

Dikush që e thotë, them se do nxitohet, se në këto zgjedhje, njeriu votohet.

Grua për Tiranën, s'do mendoja kurrë, se në fakt Tiranës, i duhet një burrë!

Nëse do votoj, do votoj njerinë, po emrat e tyre, akoma s'i dimë!

Që jam anti-grave, dikush do më thotë, po burrat gjithmonë, janë më të zotë!

Po vetëm një gjë, nuk e diskutoj, nëse rri prapë Basha, Bashën s'e votoj!

Gratë që shkëlqejné, janë shumë të rralla, se dot s'përballojnë, gjithë ato andralla!

Votën kurrë s'e çoj, gjer tek Lulëzimi, se ai nuk di, ç'është administrimi!

Nuk them se të gjitha, janë dru i shkundur, në Kuvënd-shumica, janë sa për numur!

Ai për qytetin, ka bërë fare pak, sepse ka drejtuar, si një partiak!

Na duhet një burrë, për të na drejtuar, dhe burrat akoma, këtu nuk janë shuar!

Duhet të mendojmë, mirë në qershor, se në fakt na duhet, një administrator!

Po unë vetëm shkruaj, bëj nga pak humor, sepse për të tjerat, nuk kam gjë në dorë!..



BALADË

Edhe një herë për Eseninin...

*Hej, Esenin-djalosh i ëmbël,
s'u lidhe kurrë me zinxhirë,
e shkove jetën si një ëndërr,
po zgjodhe vdekje të vështirë.*

*"Nga jeta nuk ke më ç'të presësh,
e jetës s'ke më ç'ti kërkosh,
NUK ËSHTË MË E RE-TË VDESËSH,
E REJA ËSHTË TË JETOSH!"*

*S't'u sosën kurrë margaritarët,
poet i fundit i katundit,
po pse-o mik-preve damarët,
me gjak të thurje varg'n e fundit?!..*

*Eh-edhe unë-o mik i vyer,
shpeshherë kam qënë në buzë të varrit,
por vetes paq ia kam kursyer,
dhimbjen e hidhur të damarit.*

*Kur ende s'kisha të njëzeta,
në çdo qelizë jetën ma prekje,
ndaj plot të mora ty nga jeta,
por dot s'të imitoj në vdekje.*

*Gjith' jetën mua më ka dhëmbur,
në shpirt e zëmër -dhimbja jote,
më fal-që pranë s'të jam gjëndur,
kur ti iu vodhe kësaj bote.*

*Eh-ç'mrekulli more me vete,
dashnor i zjarrtë i poezisë,
po dhe me aq-në shekuj mbete,
si një magji në mes magjisë.*

*Zoti po të më ip' fuqi,
nga gjithë ç'kanë vdekur-një të ngjall,
patjetër do të ngjallja ty,
po më me jetën mos u tall!*

*Ti-rus-gjenui i lavdishëm,
e unë shqiptar e jo më pak,
të dy bëmë vargje të magjishëm,
po jeta na qëlloi farmak...*

*Në vdekje dot s'të imitoj,
se s'është e lehtë-i shtrënyti im,
më dënoi Zoti të jetoj,
se s'pata kurrë sa ti guxim!*

*Sikur këtu të rri dhe pak,
bota asgjë nuk ka se ç'humb,
gotën e jetës-me farmak,
dua ta pi deri në fund...*

Petro Bozo çon “Miss Globe” në Toronto të Kanadasë

Formatin e spektaklit do ta bëj stafi shqiptar që ka organizoi garën e bukurisë në Shqipëri

Konkursi i bukurisë “Miss Globe” në edicionin e tij të 12-të do të organizohet në Kanada. Producenti Petri Bozo tha në konferencën për shtyp se: “Zgjidha Kanadanë, sepse është vendi më multietnik në botë, pra shumë i përshtatshëm për vetë natyrën e Miss Globe dhe ky mision i ri që i kemi vënë vetes si

qëllim, bashkarisht, i shërben formulës dhe vetë ambicies së këtij spektakli të madh”. Për organizimin e eventit në Toronto të Kanadasë do të kujdeset i njëjti staf shqiptar që për 11 vjet ka organizuar garën e bukurisë në Shqipëri. Në këtë garë që do të zhvillohet në datat 13 shtator deri në 4 tetor do të marrin pjesë rreth 60 vende të botës. “Miss Globe është një sipër-

marje e madhe botërore dhe ka një ndryshim thelbësor krahasuar me të ngjashmit e vet në botë: Ai është më shumë se një garë bukurie. Themeluesi i saj, Charlie See, kur e ka nisur, e ka filluar si një spektakël, mbi të gjitha social, në të cilin çdo konkurrenca, – pa dallim statusi social, kombësie e etnie, – do të mund të përmbushte një ëndërr”, kujtoi Bozo, i cili prej 11

Miss Globe

Do të zhvillohet në datat 13 shtator deri në 4 tetor do të marrin pjesë rreth 60 vende të botës. Petri Bozo, prej 11 vjetësh trashëgon patentën e këtij spektakli nga Charlie See

vjetësh trashëgon patentën e këtij spektakli nga Charlie See. Petri Bozo është njëkohësisht edhe producent i spektaklit “Miss Shqipëria” që zhvillohet çdo vit në Shqipëri. Ndërsa për sa i përket investimit të bërë për Miss Globe në 11 vjet resht Bozo tha se “Ky konkurs i dha Shqipërisë atë që çdo lloj politike tjetër prezantuese do të kishte nevojë për shumë më tepër kohë, punë dhe përpjekje”



photo: © GENT

kinemamillennium



NGA DATA 12 SHKURT

50 SHADES
OF GREY

INFO & REZERVIME:

04 22 53 654

04 22 53 655

0697856678

Kinema Millennium Tirana
 www.kinemamillennium.com

Partizani fajëson arbitrin, tifozët: Të largohet Duro

Ndeshja me Teutën do të luhet në Kamëz, paralajmërohet protestë nga ultrasit e kuq



3

Gola

Pësoi ekipi i Partizanit në Kupës përballë Laçit në ndeshjen e kthimit duke u eliminuar, pasi në ndeshjen e parë arriti të fitonte 2-0.



Shifrat



2

Ditë
Pas ndeshjes në Laç drejtuesit e kuq përmes një deklaratë për mediat kanë fajësuar drejtimin e arbitrit dhe mungesën e disa titullarëve.



1

Edicion
Ka Shpëtim Duro në drejtimin e ekipit të Partizanit, kontrata e lidh edhe 2 edicione me të kuqtë, por tifozët kërkojnë largimin e menjëhershëm.



41

Pikë
Ka Partizani në kampionat dhe ndodhet në vendin e 4, 6 pikë më pak se Tirana me Kukësin që kryesojnë renditjen e përgjithshme.

DYLBËR BALLA
TIRANË

Pas dy ditësh më në fund ka reaguuar klubi i Partizanit për ndeshjen e zhvilluar në Laç për Kupën e Shqipërisë, e cila u humb nga të kuqtë 3-0 duke sjellë eliminimin nga kompeticioni. Klubi fajin për eliminimin ia vendos arbitrit dhe dëmtimit të disa lojtarëve, por kërkon që të shikohet përpara drejt titullit kampion për të harruar atë që ndodhi në mesjavë. "Klubi kërkon të sqarojë mbarë opinionin sportiv në lidhje me situatën e krijuar pas rezultateve të fundit. Eliminimi nga Kupa e Shqipërisë sigurisht mund të konsiderohet një dështim për vetë objektivat që klubi kishte për këtë sezon futbolistik. Ishte një paraqitje në të cilën ndikuan shumë faktorë, dëmtime lojtarësh, por edhe gjykimi i njëanshëm i kryesorit Alla me vendimet e akorduara. Një ndeshje e cila duhet harruar sa më parë pasi përpara na pret një garë më afër dhe vështirë ku synimi i klubit tashmë mbetet vetëm fitimi i titullit kampion. Jemi plotësisht në luftë për të synuar këtë trofe, i cili i mungon 15 herë Kampionëve të vendit për afro dy dekada dhe që është aq i dëshiruar nga e gjithë familja e kuqe. Njëkohësisht kërkojmë mbështetjen maksimale të tifozëve siç na keni përkrahur jo vetëm përgjatë gjithë këtij sezoni por në çdo moment të vështirë që ka kaluar. Klubi, pa praninë tuaj në shkallët e stadiumit do ta kemi mjaft të vështirë të realizojmë objektivin madhor Titullin Kampion" mbyllet deklaratat. Por tifozët e kuq ende nuk e kanë kapërdirë atë që ndodhi duke premtuar një revoltë të fuqishme. "Ndeshja e vlefshme për javën e 23-të të kategorisë superiore Partizani - Teuta do të zhvillohet në Kamëz dhe jo në stadiumin "Redi Maloku" në Fushë-Krujë ditën e Diel, ora 14:00. Ekspertët grek të cilët vëzhgjuan terrenin e rrethuar strukturat të stadiumit "Qemal Stafa" nuk kanë dhënë "ok" për të hapur dyert për këtë takim, pasi fusha nuk është ende në gjendjen e saj optimale për zhvillimin e ndeshjeve" thuhet në njoftim. Por grupi i tifozëve "Ultras Guerrills" përmes një deklaratë shprehën se "Në jemi ata që në të mirë e në të

keq, ishim aty, jemi aty e do qëndrojmë aty. Jemi ata që dyfishojmë mbështetjen në momentet e vështira në humbje apo zhënjime pavarësisht vështirësive dhe kilometrave. Në jemi ata që nuk tradhetojmë kurrë e në momentin që ju na tradhtoni ne nuk falim. Na tradhtoat dhe ndihemi të fyer gjë që nuk do të kalojë lehtë. E dashurojmë futbollin për hir të Partizanit e duke ditur që Partizani prej këtyre lloj

skenarësh preku fundin duke arritur në pikën më të errët të historisë, e urrëjmë atë futboll tavolinash, trukimesh, shifjesh e tolerimesh. Duhet të jeni shembulli për cdo klub tjetër e jo të na trajtoni në këtë mënyrë me deklarata qesharake e me arrogancë sic bën Shpëtimi që tashmë nuk ka shpëtimi. E kërkojmë të menjëhershme dorëheqjen e tij nëse ka një farë profesionalizmi, e meqë është vetëshpallur president e ka më

të thjeshtë të shkarkojë vetveten, e në të njëjtën kohë në mënyrë zyrtare kërkojmë që Gazmend Demi dhe drejtori Sulejman Starova ta shkarkojnë nëse ai vete nuk jep dorëheqje. Dikush nga ju duhet të marrë përgjegjësi. Këtë kërkesë ja bëjmë drejt-përdrejt drejtorit. Të gjitha këto nuk përbejnë ndonjë ndryshim për ne, ne lidhje me atë cka ndodhi ama kërkojmë si sinjal për vazhdimësinë" mbyllet komunikata.



FUNDJAVA

Barça-City nxehmjen e fundit, a do t'i shënojë Meha Nojerit?

Atletiko, Chelsea, United dhe Arsenal ndeshje të lehta në letër në kampionat

Eshtë tuta futbollistike pritet që të jetë mjaft e nxehtë në kampionatet më elitare në Europë. Premier League vendos përballë kampionët e Manchester City me Newcastle, një sfidë e vështirë për Pelegrinin në prag të ndeshjes me Barcelonën. E vështirë parashikohet edhe transferta e Manchester United ndaj Swansea, ndërsa Chelsea në letër ka një ndeshje të lehtë me Burnley. Crystal Palace pret Arsenalin duke shpresuar për pikë. Në kampionatin italian të futbollit e shtuna rezervon ndeshjen Sampdoria-Genoa. Ndërsa në Spanjës, Barcelona

pret Malagan në "Camp Nou" me mendjen të Champions League në mesjavë. Trajneri Enrique shprehet se e gjithë vëmendja do të jetë e përqendruar te ndeshja me Malagan përpara asaj të Manchester City. Kampionët e Atletikos së Madridit kërkojnë rikthimin të fitorja me Almerian pas humbjes javëve parë me Celta Vigon. Sytë e shqiptarëve do të jenë në Gjermani, aty ku Paderborni i Mehës do të presë Bayernin. Meha ka premtuar se do t'i shënojë Nojerit. Gjithcka mbetet për t'u parë nëse shqiptari nga Kosova do të lërë gjurmë në këtë ndeshje. Në ndeshjen e fazës së parë Meha nuk kishte në formë, pasi kaloi një dëmtim që e mbajti larg fushës për disa muaj, por tashmë ndodhet në momentin më të mirë të mundshëm. Në Francë PSG kanë një përballje të lehtë me Toulouse. Megjithatë trajneri Blanc duke pasur në konsideratë ndeshjen e javës së kaluar kërkon vlerësim të kundërshtarit deri në fund.

Shkurt

SERIE A

Pirlo përmbys Atalantën Juve gati për Dortmundin

Gjeniu Andrea Pirlo i jep një tjetër fitore me pesë Juventusit në kampionat përballë Atalanës. Kampionët e Italisë fituan 2-1 me përmbysje përballë miqve duke treguar se janë gati për ndeshjen e radhës me Dortmundin në Champions League. Juve e nisi keq pasi pësoi me Giulio Migliaccio, por falë spanjollit Lorente dhe mesfushorit Pirlo arriti të kthente rezultatin.

BUNDESLIGA

Dortmundi mund Stuttgartin dhe ngjitet në vendin e 10

Aubameyang, Guendogan dhe Reus i dhanë fitoren ekipit të Borussia-s së Dortmundit përballë Stuttgart me rezultatit 2-3 duke i ngjitur në vendin e 10 me 25 pikë në 22 ndeshje, një më shumë se kundërshtarët, të cilët do të luajnë sot dhe mund ta zbrisin. Megjithatë e rëndësishme është që Dortmundi siguron fitoren e 3 radhazi në kampionat pas krizës së rezultateve që po kalon këtë edicion duke larguar "fantazmat" e rënies.



LAJME
nga bota

**Greqia,
marrëveshje
për borxhet**

— Greqia dhe Gjermania duket të kenë arritur një marrëveshje, që do të jepte mundësinë e zgjatjes edhe për gjashtë muaj të tjerë të planit të ndihmës financiare për Athinën, që skadonte në 28 shkurt. Marrëveshja ka qenë e karakterit politik, por do të kalojë edhe në shqyrtimin e ministrave të Financave të Eurogrupit, që u zhvillua dje. Këtë e konfirmoi zëdhënësi i delegacionit zyrtar grek në Bruksel, Panajotis Agrafiotis. Pritet që shqyrtimi të zgjatë disa ditë, pasi duhet kohë për të përcaktuar hollësitë teknike për ta bërë atë të realizueshme, shtoi ai. Në rast se Eurogrupi do të thoshte jo, Tsipras do të kishte kërkuar thirrjen urgjente të dielën të liderve të BE-së.

**Publikohen
skandale në
Maqedoni**

— Publikohet skandali i tretë nga lideri i opozitës maqedonase Zoran Zaev, nga seria e përgjimeve dhe bisedave telefonike, të kryera nga kabineti qeveritar i kryeministrit Nikolla Gruevski, por jo vetëm. Përmes një konference për mediat, kreu i Partisë Social-Demokrate të Maqedonisë ka publikuar material që kanë të bëjnë me arrestimin e Lube Boshkovskit. Po ashtu, pjesë e "bombës" së tretë janë edhe të dhënat lidhur me vrasjen e të riut Martin Neshkovski dhe tentativat e pushtetit për të penguar protestat e opozitës.

**Terrorizmi
godet në Afrikë**

— Të paktën 25 persona kanë mbetur të vrarë dhe 30 janë plagosur pas sulmeve të njëpasnjëshme me bomba në lindje të Libisë, në al-Qubbah. Lajmi bëhet me dije nga mediat locale, sipas të cilave ka pasur tre shpërthime me bomba: njëra ndaj një karburanti, një tjetër ndaj një rajoni policie dhe bomba e tretë ndaj shtëpisë së zëdhënëses së parlamentit. Sipas zyrtarëve shpërthimet e bombave mund të jenë të lidhura me sulmet e fundit ajrore të Egjiptit ndaj militantëve të shtetit islamik, pas ekzekutimit të 21 egjiptianëve të krishterë dhe mendohet se kanë shkakuar mbi 50 viktima. Ndërkohë dhe në kryeqytetin e Somalisë është regjistruar një sulm në një hotel, ku mendohet se janë vrarë më se 20 vetë.

abissnet¹⁵
PERJETONI SHPEJTESINE

DOWNLOAD 15.0 Mbps UPLOAD

ADSL2+ FNSH

INTERNET SUPER SPEED 2000 lekë/muaj

Rr. Ismail Qemali, Pallati Abissnet, Tiranë | 00355 4 4300 123 | sales@abissnet.al | www.abissnet.al

Alba Malltezi - Drejtore e Përgjithshme e Free and Fair Media Group ; Aurel Pepa - Zv/kryeredaktor
Genc Kondi - Administrator i Përgjithshëm; Admirina Peçi - Kryeredaktore e "Rilindasi"; Politika: Juxhin Mustafaraj ; Ekonomi: Lorenc Rabeta; Aktualitet: Elton Qyno ;
Social: Sonila Isaku; Kulturë: Dhurata Hamzai; Sporti: Dylber Balla; Design: Altin Allaj, Erjon Ymeri; Website: Greta Malaj; Shpërndarja: Spiro Meshini cel: +355696088847

Departamenti i Marketingut:
Vera Përleka
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: KLASS shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë